



“Flood North Albania”, ministri i Mbrojtjes Vengu: Shqipëria e përgatitur në përballimin e emergjencave



faqe 3



GJENERALLEJTËNANT ARBEN KINGJI: SHQIPËRIA, E GATSHME PËR BASHKËPUNIMIN NË FUSHËN E MBROJTJES DHE SIGURISË

Shefi i Shtabit të Përgjithshëm të FARSH, zhvilloi një vizitë zyrtare në Shtetet e Bashkuara të Amerikës, ku u prit në një takim të veçantë nga shefi i Byrosë së Gardave Kombëtare të Shteteve të Bashkuara të Amerikës, gjeneral Steven S. Nordhaus. Gjenerallejtnant Kingji gjatë takimit i shprehu gjeneral Nordhaus mirënjohjen...



faqe 2



ZËVENDËSMINISTRJA E MBROJTJES, BLERINA ABRAZHDA MORI PJESË NË TAKIMET E NATO-s NË BRUKSEL

Zëvendësministria e Mbrojtjes, znj. Blerina Abrazhda, mori pjesë në takimet e nivelit të lartë të ministrave të Mbrojtjes të vendeve anëtare të NATO-s, të zhvilluara në Bruksel. Takimet përfshinë Mbledhjen e Koalicionit të Vullnetit si dhe Takimin e Grupit të Kontaktit të Mbrojtjes për...



faqe 3



PËR TY, QË JE GRUA SHQIPTARE: NGA HESHTJA NË ZË

ANJEZA MUSOLLARI,
Shefe e Sektorit të Botimeve

Manifest i heshtur i grave shqiptare, një pasqyrë e realitetit të shumë prej tyre, por edhe një thirrje për vetëdije, forcë dhe ndryshim. Për ty, që je grua shqiptare si unë! Të jesh grua shqiptare do të thotë të rritesh në një shtëpi që nuk është plotësisht e jotja, me njerëz që janë të tutë, por edhe të huaj njëkohësisht. Pastaj, martohesh...



faqe 6

Gjenerallejtënant Arben Kingji: Shqipëria, e gatshme për bashkëpunimin në fushën e mbrojtjes dhe sigurisë

Shefi i Shtabit të Përgjithshëm të FARSH, zhvilloi një vizitë zyrtare në Shtetet e Bashkuara të Amerikës, ku u prit në një takim të veçantë nga shefi i Byrosë së Gardave Kombëtare të Shteteve të Bashkuara të Amerikës, gjeneral Steven S. Nordhaus.

Gjenerallejtënant Kingji gjatë takimit i shprehu gjeneral Nordhaus mirënjohjen për mbështetjen e vazhdueshme të Forcave të Armatosura të SHBA-së përmes stërvitjeve bilaterale dhe shumëkombëshe, shkëmbimeve të ekspertizës dhe ndihmës së specializuar, që kanë ndikuar ndjeshëm në rritjen e profesionalizmit të personelit tonë dhe në përafrimin e procedurave të veprimit me standardet e NATO-s.

Nga ana e tij, gjeneral Nordhaus, vlerësoi Shqipërinë si një partner dhe aleat të çmuar të SHBA-ve në Ballkanin Perëndimor, duke e cilësuar partneritetin tonë me Gardën Kombëtare të New Jersey-it si një nga më të suksesshmit në Evropë, një shtysë kjo për ta zhvilluar më tej këtë bashkëpunim.

Gjatë takimit SHSHPFA, gjenerallejtënant Arben Kingji ka rikonfirmuar angazhimin e Shqipërisë dhe FARSH për të vijuar bashkëpunimin në fushën e mbrojtjes dhe sigurisë, me objektiv të përbashkët forcimin e gatishmërisë, ndërveprueshmërisë dhe kontributin në sigurinë kolektive. Gjatë vizitës zyrtare në SHBA, gjenerallejtënant Arben Kingji, ka zhvilluar dhe një takim me komandanten e Gardës Kombëtare të New Jersey-it, gjeneral brigade Mays, ku u riafirmua angazhimi i përbashkët për thellimin e bashkëpunimit nëpërmjet



Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë dhe Gardës Kombëtare të New Jersey-it.

Gjenerallejtënant Kingji, gjatë takimit shprehu mirënjohjen për mbështetjen e vazhdueshme në fushën e trajnimit, edukimit dhe stërvitjes të personelit të FARSH.

Pjesë e axhendës zyrtare në SHBA, e SHSHPFA, gjenerallejtënant Arben Kingji, ka qenë edhe pjesëmarrja në ceremoninë e kthimit në atdhe të Brigadës së 44-të “The New Jersey National Guard”, pas përfundimit me sukses të misionit të tyre në Lindjen e Mesme.



FAj, pjesë e stërvitjes “Flood North Albania”



Në kuadër të operacionit stërvitor ndërkombëtar “Flood North Albania”, të zhvilluar për një periudhë 3 - ditore në rajonin e Shkodrës, Forca Ajrore pati kontributin e saj në bashkëpunim të ngushtë me AKMC dhe me strukturat qendrore dhe lokale, për ardhjen në ndihmë të popullsisë së bllokuar nga përmbytjet ku rruga e vetme për shpëtimin e tyre ishte evakuimi nga ajri.

Forca Ajrore në këtë stërvitje u angazhua me 3 helikopterë, “Cougar” dhe “Black Hawk”, si dhe me një personel prej 15 vetash, duke realizuar demonstrime sipas skenarëve të stërvitjes, që pasqyronin sfidat reale në raste fatkeqësish natyrore.

U zhvilluan demonstrime që përfshinin operacione shpëtimi për banorët e izoluar nga uji, duke u ndërmarrë dhe veprime për evakuim, si dhe operacione të kërkim - shpëtimit të personave të humbur, ose që mund t'i ketë marrë rrjedha e ujit.

Përmes këtyre skenarëve u synua testimi i kapaciteteve, rëndësia e veprimit të përbashkët në situata emergjente, si dhe reagimi i shpejtë dhe i sinkronizuar për të shpëtuar jetë dhe mbrojtur komunitetin.

Prej disa ditësh, Shqipëria mikpritit stërvitjen “Flood North Albania”, një ushtrim i përmasave rajonale dhe ndërkombëtare, për përballimin e emergjencave civile, ku morën pjesë 13 partnerë nga 8 shtete të Ballkanit dhe më gjerë.

Në përmbyllje të stërvitjes, efektivet i vizitoi edhe ministri i Mbrojtjes, Pirro Vengu, i cili gjatë fjalës së tij, theksin e vuri mbi rëndësinë e kësaj stërvitjeje si një moment domethënës për Mbrojtjen Civile në Shqipëri dhe një dëshmi konkrete e angazhimit të vendit tonë në Mekanizmin e Mbrojtjes Civile të Bashkimit Evropian.

“Shqipëria është ndër vendet më të prekura nga përmbytjet në Evropë, me rreth 50.000 qytetarë të prekur çdo vit dhe dëme, që kapin vlerën e 35 milionë eurove. Prandaj, mbrojtja civile është kthyer në një prioritet strategjik për qeverinë dhe një pjesë e konsiderueshme e investimeve tona mbrojtëse janë përqendruar pikërisht në këtë fushë. Sot mund të themi me bindje se jemi më të përgatitur. Kemi ngritur strukturat e nevojshme, kemi investuar në infrastrukturë parandaluese dhe kemi forcuar ndjeshëm bashkëpunimin me partnerët ndërkombëtarë”, - nënvizoi ministri i Mbrojtjes.

Sipas tij, kjo stërvitje është një provë konkrete e këtij progresi dhe e frymës rajonale të bashkëpunimit.

“Qasje të tilla të përbashkëta, si kjo stërvitje, ndihmojnë më tej në mbledhjen e ekspertizës dhe kapaciteteve të reaguesve të parë, shmang mbivendosjen e përpjekjeve të ndihmës duke mundësuar një përgjigje kolektive më të fortë dhe më koherente”, - u shpreh ministri Vengu. Ndër të tjera, ministri i Mbrojtjes evidentoi faktin se, tashmë Shqipëria është pjesëmarrëse në Mekanizmin e Mbrojtjes Civile të BE-së dhe jep kontributin në tryezat, ku përgatiten politikat, masat, aktet e Mbrojtjes Civile për të gjithë hapësirën e Ballkanit e të BE-së, por edhe me ndihmë konkrete në terren.

Ministri i Mbrojtjes, shoqëruar edhe nga drejtori i Agjencisë Kombëtare të Mbrojtjes Civile, z. Haki Çako dhe përfaqësues të vendeve partnere ndoqën nga afër edhe demonstrimet e forcave në një operacion të simuluar kërkim - shpëtimi, evakuim të banorëve dhe gjësë së gjallë si dhe largim uji me pompa me kapacitet të lartë, që u zhvillua në zonën e Dajçit, në Shkodër.

Në këtë demonstrim morën pjesë ekipe nga Shqipëria, Bullgaria, Italia, Greqia dhe



“Flood North Albania”, ministri i Mbrojtjes Vengu: Shqipëria e përgatitur në përballimin e emergjencave



ekipi i BE-së. Stërvitja “Flood North Albania” shërbeu për të testuar përgatitjen dhe kapacitetet reaguese të forcave të Mbrojtjes Civile për përballimin e përmbytjeve, për të vlerësuar gatishmërinë e institucioneve vendase dhe për të forcuar koordinimin mes autoriteteve kombëtare

dhe ndihmës ndërkombëtare.

Ky ushtrim shënon gjithashtu një sukses organizativ për Agjencinë Kombëtare të Mbrojtjes Civile të Shqipërisë, e cila ka një rol kyç si lider i projektit, që financohet nga DG ECHO – Bashkimi Evropian (Directorate-

General for European Civil Protection and Humanitarian Aid Operations). Projekti nisi në janar 2024 dhe pritet të përfundojë në dhjetor 2025, me pjesëmarrjen e vendeve partnere si Mali i Zi, Kosova, Greqia, Italia, Qipro, Maqedonia e Veriut dhe Bullgaria.



Zëvendësministria e Mbrojtjes, Blerina Abrazhda mori pjesë në takimet e NATO-s në Bruksel

Zëvendësministria e Mbrojtjes, znj. Blerina Abrazhda, mori pjesë në takimet e nivelit të lartë të ministrave të Mbrojtjes të vendeve anëtare të NATO-s, të zhvilluara në Bruksel.

Takimet përfshinë Mbledhjen e Koalicionit të Vullnetit si dhe Takimin e Grupit të Kontaktit të Mbrojtjes për Ukrainën, ku u diskutua mbi vijimin e mbështetjes për Ukrainën dhe hapat drejt një armëpushimi të qëndrueshëm.

Të pranishëm ishin edhe sekretari i Përgjithshëm i NATO, z. Mark Rutte, përfaqësuesja e Lartë për Politikën e Jashtme dhe të Sigurisë së BE, znj. Kaja Kallas, si dhe përfaqësues të vendeve aleate të NATO.

Z. Rutte vlerësoi kontributet e shteteve aleate, në veçanti ato evropiane, për rritjen e ndihmës ushtarake ndaj Ukrainës në vitin 2025. Ai inkurajoi vazhdimin e angazhimeve, përfshirë mbështetjen për Paketën Gjithëpërfshirëse të Ndhmës të NATO për Ukrainën, duke theksuar rëndësinë e vijimit të mbështetjes për të arritur një paqe të drejtë dhe të qëndrueshme.

Në kuadër të këtyre përpjekjeve të përbashkëta, Shqipëria vazhdon të kontribuojë në mbështetjen e Ukrainës, duke dëshmuar qartë solidaritetin euroatlantik dhe përkushtimin për paqe dhe siguri në rajon dhe më gjerë.



Studentet e AFA-së vizitojnë “West Point”, SHBA



Dy studente të vitit të tretë të programit “Shkenca Ushtarake” në Akademinë e Forcave të Armatosura morën pjesë në programin shkëmbimor “Exchange Programme” në Akademinë Ushtarake prestigjioze “West Point” në SHBA.

Gjatë vizitës, ato ndanë eksperiencat e tyre ushtarake me kadetë nga vende të ndryshme të botës dhe morën pjesë në aktivitete akademike dhe kulturore. Studentet e vlerësuan programin si një përvojë unike dhe frymëzuese, duke sjellë me vete rekomandime të vlefshme për përafrimin e mëtejshëm të AFA-së me standardet ndërkombëtare të edukimit ushtarak.



Kompania EOD, vazhdon misionin në eliminimin e rreziqeve nga municionet e paplasura

Efektivët e Kompanisë EOD janë angazhuar në operacione në mbështetje të Emergjencave Civile në bashkinë Delvinë dhe Poliçan.

Me kërkesë të AKMC-së, grupi EOD i Batalionit të Xhenios, në bashkëpunim me strukturat përkatëse, zhvilloi një operacion për identifikimin dhe largimin e municioneve të paplasura në Bashkinë Delvinë.

Municionet e artilerisë u gjetën dhe u larguan në zonën “Mulliri i Bardhë”, përgjatë rrugës Delvinë-Sarandë, duke eliminuar rrezikun për sigurinë e komunitetit dhe lëvizjen e qytetarëve.

Ekipi EOD i Batalionit të Xhenios realizoi një tjetër operacion për vlerësimin, asgjësimin dhe transportimin e municioneve të paplasura të gjetura në fshatin Terpan, bashkia Poliçan.

Përmes një vlerësimi profesional dhe të kujdesshëm operatori EOD konstatoi se municioni, predhë topi 100 mm, e cila i përket periudhës së Luftës së Dytë Botërore, ishte e lëvizshme, duke bërë transportimin dhe magazinimin e saj.

Kompania EOD vazhdon të përmbushë misionin e saj për pastrimin e territorit nga municionet e rrezikshme, duke siguruar jetën e popullsisë civile.



Efektivë të Forcës Detare morën pjesë në trajnimin “Dhënia e Ndhimës së Parë”

Efektivë të Forcës Detare morën pjesë në trajnimin “Dhënia e Ndhimës së Parë”, të organizuar nga Qendra Kombëtare e Urgjencës Mjekësore.

Ky trajnim synon përgatitjen e personelit që do të ushtrojë rolin e paramedikut, veçanërisht në anijet e Forcës Detare, duke i aftësuar për të ndërhur në situata të ndryshme emergjente.

Pjesëmarrësit u trajnuan mbi teknikat dhe njohuritë themelore të ndihmës së parë, me qëllim që të jenë të gatshëm t'i vijnë në ndihmë kolegëve në rast nevojë.

Trajnimi u zhvillua në kuadër të programit “Të parët në vendngjarje” (First On The Scene – FOTS), në bashkëpunim me NAEMT dhe Qendrën Kombëtare të Urgjencës Mjekësore.



Baza e Mbështetjes dhe Emergjencave Civile mori pjesë në stërvitjen “Flood North Albania 25”

Efektivët e Bazës së Mbështetjes dhe Emergjencave Civile u angazhuan në kuadër të stërvitjes ndërkombëtare “Flood North ALB 2025”, e cila u zhvillua në qarkun Shkodër.

Ekipi i BMEC i përbërë nga 40 efektivë, u përfaqësua denjësisht në këtë stërvitje krah ekipeve të gjashtë shteteve të huaja pjesëmarrëse.

Qëllimi i stërvitjes ishte testimi i kapaciteteve të ekipeve të kërkim-shpëtimit, forcimi i bashkëpunimit ndërinstitucional dhe përmirësimi i koordinimit mes strukturave vendore, qendrore dhe ndërkombëtare, në përputhje me mekanizmin e Mbrotjes Civile të Bashkimit Europian.

Gjatë stërvitjes efektivët tanë realizuan skenarë të ndryshëm për përballimin e situatave në rast përmytje, duke demonstruar përgatitje të lartë profesionale dhe zotërimin e kapaciteteve të duhura për të mbështetur autoritetet e emergjencave civile.

Personeli i BMEC ndër të tjera punoi për ngritjen e rajonit të fushimit për 250 trupa pjesëmarrës, me të gjitha kapacitetet mbështetëse të nevojshme.

104 vite nga Parlamenti i parë shqiptar

Plot 104 vite më parë, paraditen e 21 prillit 1921 (saktësisht në orën 10:00), për herë të parë në historinë e Shqipërisë do të niste punimet Parlamenti. Ishte një ngjarje historike për Shqipërinë, ku për herë të parë 56 deputetë të zgjedhur nga vullneti i popullit do të uleshin në parlamentin shqiptar.

Pas hapjes së sesionit prej Dhimitër Kacimbrës, (Kryetar i Këshillit Kombëtar) Pandeli Evangjeli merr fjalën i dyti si i zgjedhuri për të kryesuar Këshillin Kombëtar në këtë legjislaturë. Procesverbal i seancës së parë të Këshillit Kombëtar ruhet në origjinal në Arkivin Qendror Shtetëror dhe është i botuar në disa variante, i pari po në vitin 1921.

Parlamenti i vitit 1921, i cili u formua pas këtij procesi zgjedhor, të parit në vend, njihet për nivelin e lartë të përfaqësimit pasi të zgjedhurit ishin intelektualët më të zëshëm të kohës.

Godina në të cilën u mblodh parlamenti, në vitet 1928-1939, u bë “Pallati Mbretëror” dhe sot është selia e Akademisë së Shkencave të Shqipërisë.

Hapja e parlamentit të parë shqiptar në Tiranë, më 21 prill 1921, tërhoqi vëmendjen e korrespondentit të gazetës “Chicago Daily News”, i cili na jep një përshkrim të rrallë në numrin e datës 26 prill, si dëshmitar i ngjarjes.

Ja se si vjen sot nga “Chicago Daily News” ky hap i rëndësishëm i politikës shqiptare: SHQIPËRIA E RE PO LIND THUAJSE SI AMERIKA.

“Asnjëherë e rreptë dhe e sinqertë me fqinjët, shpallet si synim i vendit”, nga, EDGAR ANSELM MOWRER.

Tiranë, Shqipëri, 22 prill - Për herë të parë në jetën time jam i pranishëm në lindjen e një shteti. Në prani të përfaqësuesve të Italisë dhe Britanisë së Madhe dhe anëtarëve të Kryqit të Kuq Amerikan u zhvillua sot seanca e dytë e Kuvendit të Shqipërisë. Ndërsa shikoja punimet, mu kujtuan rrëfimet historike për seancat e gjata që mbaheshin dikur në Filadelfia, nga të cilat dalëngadalë lindi kushtetuta amerikane. Të huajt që janë të prirur të qeshin me shqiptarët - me varfërinë e tyre, mungesën e përvojës, mentalitetin turk dhe grindjet personale apo fetare, duhet të kujtojnë se si u formuan Shtetet e Bashkuara.

Organet qeverisëse, të dala prej kuvendit të patriotëve, përbëhen nga një lloj regjence prej katër anëtarësh, me një kabinet dhe një dhomë deputetësh, por vetëm tani përfaqësuesit e parlamentit, i pari i zgjedhur ligjrisht dhe me votën e popullit, mblidhen si individë të lirë. Duke përshëndetur anëtarët e organit ligjvënës, dr. (Mihal)



Turtulli i regjencës tha se, politika shqiptare bazohet në “asnjanësinë e rreptë dhe të sinqertë me fqinjët” dhe se shpresonte që negociatat e pritshme për zbrazjen e trojeve shqiptare të mbajtura në mënyrë të paligjshme nga vendet e tjera do të përfundonin me sukses.

“Që Shqipëria është në gjendje të shkëlqyer, - tha ai, - këtë e tregon legjitimiteti i zgjedhjeve dhe qetësia që mbretëron në të gjithë vendin”.

VENDI NDESHET ME VËSHTIRËSI

Megjithatë, Shqipëria po përjeton disa vështirësi. Rivaliteti fetar ka penguar zgjedhjet në Shkodër; zgjedhjet e Dibrës po kontestohen, ndërsa qarku i Himarës, ku grekët janë të fortë, ndodhet në një lloj revolte. Në Gjirokastrë dhe Korçë elementi shqiptar ka mbizotëruar plotësisht.

Anëtarët e parlamentit të ri janë jashtëzakonisht demokratikë. Sot në mëngjes, me miratim të njëzëshëm, u hoqën titujt “bej” dhe “pasha” me origjinë turke dhe një nga

aktet e para të asamblesë së re do të jetë miratimi i ligjit për heqjen e të gjithë titujve. Tani e tutje të gjithë njerëzit do të quhen “zoti” ose “z.”. Parlamenti i ri ndoshta do të jetë republikan edhe në frymë dhe, ndonëse mendohet se një formë monarkike e qeverisjes ka disa avantazhe, vendi mund të shpallet Republika e Shqipërisë.

Disa nga dallimet fetare u zgjidhën pjesërisht sot në mëngjes, kur Imzot Fan Noli dhe kleriku mysliman Hoxha Kadri, bashkëpunuan si pjesë e një komisioni. Asambleja e re është shumë nacionaliste. Procedurat janë solemne dhe seancat po zhvillohen në një sallë që duket si klasë shkolle në shtëpinë e dikurshme të familjes së Esat Pashës. Gjithçka është tepër e thjeshtë. Anëtarët e asamblesë janë të tipave nga më të ndryshmit, nga evropiani kozmopolit e deri te kryeplaku i fshatit. Anëtari më i vjetër, që është kryetari i përkohshëm, ka moshën nën 60 vjeç dhe Asambleja është ndoshta më e reja në botë si moshë. Shumë prej deputetëve

mbajnë feste shqiptare të zeza ose të bardha, ndërsa të tjerë nuk kanë asgjë në kokë. Hoxha Kadri mban një çallmë të bardhë mbi fesin e kuq.

NJË KUVEND PIKTORESK DHE SOLEMN

Asambleja është sa piktoreske aq edhe solemne. Përbërja e saj duhet t'i bindë pesimistët se e kanë gabim kur deklarojnë se luftërat fetare do ta përçajnë Shqipërinë dhe kur flasin me përbuzje, duke e quajtur këtë vend një “Turqi të vogël”. Sigurisht që vështirësitë janë të mëdha, por vullneti për t'i tejkaluar ato dhe patriotizmi i madh i anëtarëve, për mendimin tim, janë në nivelin e vështirësive.

Vendi ka nevojë për ndihmën e huaj. Dështimi i fuqive për ta njohur Shqipërinë mund ta vonojë, por nuk mund të pengojë përgjithmonë formimin e këtij shteti të ri, ideali i të cilit janë Shtetet e Bashkuara. Sot shqiptarët po kryejnë me vetëbesim punën për shndërrimin e fshatit të Tiranës në kryeqytetin e një shteti të vogël, por aktiv dhe modern.





ANJEZA MUSOLLARI,
Shefe e Sektorit të Botimeve

Manifest i heshtur i grave shqiptare, një pasqyrë e realitetit të shumë prej tyre, por edhe një thirrje për vetëdije, forcë dhe ndryshim.

Për ty, që je grua shqiptare si unë!

Të jesh grua shqiptare do të thotë të rritesh në një shtëpi që nuk është plotësisht e jotja, me njerëz që janë të tutë, por edhe të huaj njëkohësisht. Pastaj, martohesh dhe shkon në një tjetër shtëpi, që të thonë se është jotja, por prapë ndihesh mysafire mes fytyrash të panjohura. Të jesh grua shqiptare do të thotë të zgjohesh çdo mëngjes me një buzëqeshje të përmbajtur dhe një përshëndetje të ngrohtë: “Mirëmëngjesi, a keni pushuar mirë?”, ndërkohë që ndihesh e zhveshur përballë vështirësive që të matin nga këmbët deri në kokë. Në mbrëmje, ti ulesh në cep, shikon të tjerët të pushojnë, ndërsa vetes i thua: “Duket sikur po i ruaj, jo po pushoj”. Të jesh grua shqiptare është të të thuhet se është turp të flasësh, por jo turp të pastrosh shtëpinë në ditën e dytë të martesës, me duar që ende nuk janë tharë nga lotët e lamtumirës. Të jesh grua shqiptare është të mbash mbi supë peshën e një familjeje që kurrë nuk e ke zgjedhur dhe as të ka zgjedhur ty.

Të jesh grua shqiptare është të të përshëndesin me buzëqeshje, por pas shpine të ndërtojnë rrjeta dredhish, pikërisht në shtëpinë që quhet “e jotja”, por që kurrë nuk do ta ndjesh të tillë. Por ti qëndro, grua shqiptare. Qëndro, jo për të duruar, por për të lulëzuar. Bëhu e bardhë e bukur si bora, por ftohtë dhe e fortë si ajo, për këdo që guxon të të shkelë. Respekto, por mos u nënshtro. Duaj, por mos u shuaj për ata që të shohin si të zakonshme. Fol, kur është koha për të folur. Mbroje veten, se askush s’e bën më mirë se ti. Mos e ul kokën, se nëse nuk flet sot, nesër vajza jote do të trashëgojë të njëjtën heshtje.

Të Jesh Grua Shqiptare -

Midis Traditës dhe Vetëzgjimit

Të jesh grua shqiptare do të thotë të jetosh një realitet të ndërthurur mes krenarisë, sakrificës dhe peshës së padukshme që shpesh mbartet në heshtje. Është një përvojë që përthith gjurmët e historisë, të zakoneve, të rolit të trashëguar, por që sot, gjithnjë e më shumë, po shtyn drejt një vetëdijeje të re. Ajo që dikur përkufizohej si “forcë në durim”, po transformohet në forcë për të ndryshuar. Gruaja shqiptare lind dhe rritet në një shtëpi që shpesh nuk i përket plotësisht. Ajo mësohet që nga vogëlia të jetë e sjellshme, e heshtur, ndihmuese. Nuk pyetet gjithmonë për ëndrrat apo dëshirat e saj, por më shumë për sjelljen, për pastërtinë, për shërbimin ndaj të tjerëve. Edukimi i saj, në shumë raste, bëhet jo për të ndërtuar veten, por për të përmbushur pritshmëritë e një rrethi që e shikon si shtyllë të familjes, por rrallëherë si individ me zë dhe dëshirë.

Martesa për shumë gra shqiptare ka qenë dhe mbetet një kapitull i vështirë. Ajo shpesh perceptohet jo si një zgjedhje, por si një kalim simbolik nga një shtëpi në një tjetër. Në vend që të jetë, vend i dashurisë dhe partneritetit, ajo bëhet një tjetër provë për durimin dhe përshtatshmërinë.

Gruaja shqiptare ndodh të përballet me një realitet ku dashuria matet me shërbim, ku vlerësimi jepet në heshtje, dhe ku liria është luks, jo e drejtë.

Por përtej këtyre kufijve të vendosur nga një shoqëri që ende mban gjurmët e patriarkalizmit, po ngrihet një brez i ri grash shqiptare që nuk pranojnë më të jenë thjesht përmbajtëse të dhimbjes. Ato nuk janë më vetëm durimtare, janë krijuese, zëdhënese, drejtuese dhe guximtare. Ato kanë kuptuar se të heshtësh nuk është më vlerë, dhe se të duash veten nuk është egoizëm, por mbijetesë.

Të jesh grua shqiptare sot, është të jesh në kufirin mes dy botëve, asaj që trashëgon dhe asaj që do të ndërtohet. Është të mbash mbi supë kujtimet e nënave tona, por të mos lejojmë që vajzat tona të trashëgojnë të njëjtën heshtje. Është të ngresh zërin jo për t’i kundërshtuar gjithmonë të tjerët, por për të treguar se edhe ti ke diçka për të thënë, dhe që ajo gjë vlen.

Për Ty, që je Grua Shqiptare: Nga Heshtja në Zë



Gruaja shqiptare nuk është më vetëm një simbol sakrifice. Ajo është një forcë që po rikrijon vetveten, që po i thotë jo rolit të viktimës, dhe po ecën drejt një të ardhmeje ku të qenit grua nuk është barrë, por krenari.

Të jesh grua shqiptare është një përvojë që shkon përtej përkufizimeve të zakonshme gjinore. Është një ndërthurje mes dashurisë dhe detyrimit, mes ëndrrës dhe sakrificës, mes heshtjes së trashëguar dhe zërit që kërkon të dëgjohet. Ajo është bijë, nuse, nënë, por mbi të gjitha, qenie që ka mësuar të jetojë në kufijtë e të mundurës.

Gruaja shqiptare sot nuk është më thjesht një viktimë e sistemit. Ajo është një forcë që sfidon rrënjët patriarkale, që flet në emër të vajzës që nuk guxon, që mbron të drejtën për të zgjedhur, për të folur, për të jetuar me dinjitet.

Ndryshimi nuk ndodh brenda natës. Historia e njerëzimit e ka dëshmuar se rrugët drejt barazisë, drejt të drejtave dhe drejtësisë sociale kanë qenë të mbushura me përpjekje të vazhdueshme, sakrifica dhe zëra që shpesh janë përpjekur të heshtin. Në këtë udhëtim të gjatë dhe shpesh të dhimbshëm, gruaja ka qenë simbol i qëndrësës, i luftës së heshtur dhe më së shumti – i ndryshimit.

Çdo grua që ngre zërin përballë padrejtësisë, çdo grua që nuk përkulet përballë paragjytimeve, është një akt vetëdijesimi, por edhe një akt revolucionari. Ajo nuk përfaqëson vetëm veten, por të gjitha gratë që ende nuk kanë mundësinë apo guximin të flasin. Kjo është arsyeja pse zëri i një gruaje nuk është vetëm zë, por jehonë. Jehonë që shpërthen heshtjen shekullore të nënshtimit.

Të jesh grua, për shumë gjatë, është parë si barrë. Shoqëria ka vendosur kufij, ka ndërtuar pritshmëri dhe role të ngurta që e kanë kufizuar potencialin e gruas vetëm në funksion të të tjerëve – si nënë, si grua, si kujdestare. Por ky perceptim po ndryshon, dhe ndryshimi ndodh pikërisht kur gratë zgjedhin të mos rrinë më në heshtje. Kur zgjedhin të jenë lidere, aktiviste, mësuese, shkencëtare, artiste – dhe mbi të gjitha, të jenë vetvetja.

Shoqëria e së ardhmes është ajo që e njeh gruan si bekim. Sepse një grua e lirë, e fuqizuar, është pasuri për gjithë komunitetin. Ajo sjell një perspektivë tjetër, ndjeshmëri dhe forcë që nuk e përjashton burrin, por e plotëson atë. Barazia gjinore nuk është një betejë kundër burrave, por një përpjekje për një bashkëjetesë më të drejtë, më të ndershme, më të njerëzishme.

Për të arritur këtë, duhet të pranojmë se rruga është e gjatë. Por çdo hap, sado i vogël, ka peshën e një ndryshimi të madh. Kur një vajzë mëson se zëri i saj ka rëndësi, kur një grua nuk ndëshkohet për guximin e saj, kur një shoqëri

nuk e përkufizon vlerën e gruas përmes sakrificës, por përmes dinjitetit – atëherë mund të themi se kemi bërë përpara.

Në fund të fundit, të jesh grua nuk është barrë. Është bekim. Por ky bekim ndriçon vetëm kur shoqëria nuk e mbulon me hijen e paragjytimeve. Dhe çdo grua që ngre zërin e saj, është një dritë më shumë drejt asaj dite kur kjo botë do ta kuptojë vërtet këtë të vërtetë.

A ka ndryshuar mendësia mbi fenomenin “femër”?

Ndryshimi nuk ndodh brenda natës. Ai është si një farë e mbjellë thellë në tokë, kërkon kohë, kujdes, dritë dhe guxim për të mbirë. Dhe në këtë tokë që shpesh është shterpë nga barazia dhe drejtësia, janë gratë ato që, me rrënjët e shpirtit të tyre të palodhur, kanë kërkuar të çelin shpresën.

Çdo grua që ngre zërin përballë padrejtësisë është si një dritare që hapet drejt së ardhmes. Një grua që nuk pranon të heshtë më, është një revolucion i vogël që nis brenda zemrës, por që përhapet në shoqëri si valë që thyen heshtjen shekullore. Sepse çdo zë gruaje që dëgjohet, është një grua më pak që e ndjen veten të padukshme.

Por për të kuptuar sa e rëndësishme është kjo luftë, duhet të mësosh të shohësh me zemër. Shikoje gruan me syrin që do doje të shihje veten, jo si dikë më pak, jo si një barrë, por si një pasqyrë e mundësive, e dhimbjes, e forcës, e dritës. Askush nuk dëshiron të gjykohej për atë që është. Askush nuk do të ndjehet i pavlerë për shkak të një identiteti të trashëguar.

Dhe ashtu siç kërkojmë mirëkuptim dhe drejtësi për veten, duhet ta ofrojmë atë për të tjerët, veçanërisht për gratë.

Të jesh grua, për shumë gjatë, ka qenë sinonim i durimit, i sakrificës, i të jetuarit për të tjerët...

Gruaja, shpirti që bart jetë, që ndërton, që shëron, që krijon. Gratë nuk janë të forta sepse nuk kanë ndjerë dhimbje, por sepse e kanë përballuar atë me dinjitet. Dhe ky dinjitet meriton të njihet, të nderohet, të mbështetet.

Shoqëria jonë nuk mund të ecë përpara duke lënë pas gjysmën e saj. Nuk mund të pretendojmë zhvillim, drejtësi e përparim nëse gratë ende heshtin nga frika, ndalohen nga paragjykimi apo mbahen pas nga pritshmëritë e padrejta. Një shoqëri e drejtë është ajo ku vajzat rriten me besimin se janë të barabarta me vëllezërit e tyre, ku nënat nuk kërkojnë leje për të ëndërruar, ku bashkëshortet nuk e humbasin veten për të ruajtur një emër.

Të jesh grua nuk duhet të jetë më një sfidë për t’u mbijetuar, por një krenari për t’u jetuar.

Brezi i parë i shkollës “Skënderbej” ishin jo vetëm nga oficerët e parë të ushtrisë sonë, por edhe më të mirët, më idealistët, plot me vlera dhe që kanë kontribut të pazëvendësueshëm në kryerjen e misionit të ri të ushtrisë tonë të sapo dalë nga lufta. ...

Ata, sot janë 2-3 herë veteran, të luftës, të shkollës dhe të llojeve të armëve dhe shërbimeve, por edhe veteranë të fushave të tjera si diplomacisë shqiptare, sportit, artit, letërsisë, mjekësisë, shkencave të tjera, etj. Këta veteranë, janë brezi jetësor i atyre viteve të shkollës “Skënderbej”, janë pjesë ndër më të rëndësishmet e vetë historisë së shkollës “Skënderbej”.

Skënderbegasit kanë arritur funksione nga më të ndryshmet në fushën ushtarake deri në zëvendësministra e ministra, dhjetëra prej tyre kanë merituar gradën madhore “gjeneral”, të tjerë janë bërë deputetë, ministra e presidentë; dhjetëra prej tyre janë shkencëtarë të njohur brenda e jashtë Shqipërisë, mjekë nga më të mirët, drejtues formacionesh të rëndësishme të NATO-s, shkrimtarë, poetë, publicistë, aktorë, këngëtarë, piktorë të shquar. E që të gjithë ia dedikojnë së pari shkollës së lavdishme “Skënderbej”, ku morën bazat e formimit intelektual, karakterin e qëndrueshëm e vullnetin për të arritur gjithçka të mundshme në jetë. Është bërë shprehje tashmë masive në mjedise të ndryshme se ‘emri skënderbegas’, vlen më shumë se një dekoratë, medalje, titull apo gradë. Ndoshta, pasivisht, ky emër po fiton qytetarinë’ e një emri epik si ato të pikave kulmore të legendave shqiptare të kohëve të kaluara... Një prej tyre është dhe gjeneral Shkëlqim Nure, komandant Korpusi.

Gjeneral Nure ka lindur më 21 nëntor të vitit 1951 në Ersekë. Arsimin shtatëvjeçar e ka kryer në shkollën “Petro Nini Luarasi” në Luaras të Ersekës. Në shtator të vitit 1966 i del e drejta e studimit për në Shkollën e Mesme të Përgjithshme Ushtarake “Skënderbej” në Tiranë. Në vitin 1970 përfundon studimet në këtë shkollë me rezultate shumë të mira dhe në vjeshtën e këtij viti, nis studimet në Shkollën e Bashkuar të Oficerëve “Enver Hoxha” po në Tiranë në specialitetin gjitharmësh. Këtë shkollë e përfundon në vitet 1970 1972 dhe titullohet oficer aktiv gjitharmësh.

Detyrën si oficer karriere e nis në funksionin e komandantit të kompanisë në brigadën e këmbësorisë në Berat, detyrë të cilën e ka kryer deri në janar të vitit 1976. Pra, në janar të vitit 1976 transferohet nga Berati dhe emërohet në detyrën e komandantit të batalionit të këmbësorisë në Kombinatin Metalurgjik në Elbasan, në këtë detyrë ka qëndruar deri në muajin shkurt të vitit 1979.

Në këtë kohë është emëruar në detyrën e shefit të Shtabit të Brigadës Sulmuese në Elbasan, ku ka qëndruar deri në vitin 1983.

Në vitet 1983-1985 kryen studimet në Akademinë Ushtarake në Tiranë. Në vitin 1985, pas kryerjes së studimeve është emëruar në detyrën e komandantit të brigadës në Brigadën e Këmbësorisë në Plasë të Korçës. Në periudhën shtator 1987 - qershor 1988, kreu kursin e kualifikimit pas akademik në Akademinë e mbrojtjes në Tiranë.

Në detyrën e komandantit të Brigadës ka qëndruar deri në qershor të vitit 1992. Prej muajit qershor të vitit 1992 deri në korrik të vitit 1988 ka kryer detyrën e komandantit të Divizionit të Këmbësorisë në Korçë.

Nga muaji qershor i vitit 1992 deri në vitin 1996, ka kryer kurse të shumta kualifikimi në Gjermani dhe Turqi. Ka arritur gradën e lartë “gjeneral-brigade”. Gjatë shërbimit në Forcat e Armatosura, është dekoruar nga Presidiumi i Kuvendit Popullor me medalje dhe urdhra të ndryshëm. Gjeneral Shkëlqim Nure ka shërbyer me përkushtim të lartë në Forcat e Armatosura duke kontribuar ndjeshëm në detyrat e ngarkuara. Me një



Kur heshtin armët, flet nderi: Sfidat e një Gjenerali



karrierë që përfshin më shumë se 40 vite shërbim, ai ka mbajtur pozita kyçe komanduese, duke demonstruar udhëheqje të jashtëzakonshme, vizion të qartë dhe aftësi të larta organizative.

Gjeneral Nure, mbetet një figurë frymëzuese për bashkëpunëtorët e tij me një trashëgimi që pasqyron integritet, atdhedashuri dhe vizion për një forcë të armatosur të përgatitur dhe moderne.

Një jetë në shërbim të Atdheut

Në çdo betim, në çdo hap që ka hedhur në uniformë, gjeneral Nure ka dëshmuar se shërbimi ndaj atdheut nuk është thjesht një detyrë, por një thirrje e shpirtit. Me një përkushtim të palëkundur dhe një dashuri të thellë për vendin, ai është bërë simbol i nderit, i sakrificës dhe i udhëheqjes së mençur.

Gjatë karrierës së tij të gjatë dhe të lavdishme, ai ka qenë më shumë sesa një oficer i lartë – ai ka qenë një frymëzim për breza të tërë ushtarakësh.

Gjeneral Shkëlqim Nure, largohet nga detyra me kokën lart, me uniformën e nderuar nga dekada shërbimi të ndershmë, dhe me një trashëgimi që do të jetojë gjatë – jo vetëm në dokumentet zyrtare, por në kujtimet dhe zemrat e atyre që patën fatin të shërbejnë nën udhëheqjen e tij.



Kartolina, e para dritare prej ku bota u njoh dhe u magjeps me bukurinë e gruas dhe veshjes tradicionale shqiptare

Bukuria e gruas dhe magjia e mrekullisë së veshjes karakteristike shqiptare patën kartolinën si përçuesin më origjinal dhe më besnik të asaj vlere unike të përkatësisë sonë identitare, e cila shërbeu si një mundësi komunikimi dhe prezantimi me kulturat dhe traditat.

“Kujtim prei Maleve t’Shqypëniis” është mbishkrimi i kësaj fotoje të “Marubit”, e cila u shumëfishua në funksion të kartolinës. Vendosja e diçiturës në pjesën poshtë dhe në të sipërme, ose ndryshimet në këtë komponent, tregojnë për shumësinë e herëve që kjo kartolinë u botua.

Historia e kartolinës shqiptare është mbi njëshekullore. Fundi i shekullit të nëntëmbëdhjetë dhe fillimi i shekullit të njëzetë është koha kur Shqipëria u fut në kartolina, kryesisht përmes një manifestimi të bukurisë karakteristike të gruas shqiptare në veçanti dhe larmisë së veshjeve të saj.

Një ndër koleksionet më të bukura të kartolinave shqiptare është ai i një autori austriak realizuar në zonën e Shkodrës, por u dominua nga fotot e Marubit. Por vitet më të mira për kartolinat shqiptare filluan pas viteve 1910-1915 e më vonë, sidomos në vitet tridhjetë, kur pati një kulminacion kartolinash shumë prej të cilave kanë arritur të mbijetojnë deri sot. Madje disa ekzemplarë të rrallë, si fotoja e publikuar, vijnë në shiten në internet. Këto kartolina shtypeshin jashtë sigurisht, shumica ishin të teknikës bardhë e zi.

Kartolinat e para janë shtypur në Turqi. Tematika e tyre përqendrohej në kostumografinë shqiptare të kohës dhe ishte kjo veçori që e shtoi vlerën e këtij lloj publikimi.

Më pas, kartolinat nisën të shtypeshin në Austri, Itali, në Konstancë të Rumanisë, dhe kudo ku kishte shqiptarë dhe shoqata shqiptare, madje edhe në Amerikë.

Autorët ishin shqiptarë ose të huaj. Ishim të panjohur dhe misterioz për një pjesë të vendeve dhe kulturave dhe kartolina u shfaq si një prezantim unik i kësaj kulture dhe tradite, vlerat e së cilës ishin po kaq perëndimore sa e çdo vendi ku ajo u pa dhe u trajtua si një befasia.

Veçantia e kartolinës qëndron te pasuria dhe shumëllojshmëria e veshjeve popullore shqiptare që u përfshi në subjekt. Ishin kartolinat nëpërmjet të cilave kaloi në një masë të konsiderueshme njohja, prezantimi dhe manifestimi i vlerave etnografike. Veshjet tradicionale shqiptare, si një prej komponentëve më unik të traditës, ushqyen kartolinën shqiptare dhe e pasuruan atë me hir dhe bukuri që përgjithësisht ishte fare e panjohur.

Kartolina udhëtoi ndoshta më shumë dhe më shpejt se çdo formë tjetër e prezantimit të këtij thesari të kombit shqiptar.

Duke cituar albanologun kanadezo-gjerman, Robert Elsie, kumtojmë se: Izolimi tradicional i shqiptarëve nga pjesa tjetër e Evropës bënë që veshjet popullore të shfaqnin tipare të veçanta dhe shpesh të rralla, të cilat mahnitën udhëtarët e parë evropianë. Në Malësinë e Veriut çdo fis, madje çdo luginë dhe fshat, kishte



veshje të veta, të cilat ishin të dukshme për popullatën në përgjithësi.

Veshjet popullore tregonin jo vetëm përkatësinë fisnore dhe fetare, por edhe – për femrat në shumë raste – nëse gruaja në fjalë ishte e martuar apo jo. Veshjet popullore shqiptare ishin në përdorim të përgjithshëm deri në vitet ’30, dhe në disa treva shqiptare edhe pas Luftës së Dytë Botërore. Madje edhe në dhjetëvjeçarët e parë të shekullit të njëzetën nuk është gjë e rrallë të shohësh gra të cilat përdorin veshje popullore përditë, apo të paktën në ditën e pazarit. Kjo vlen në radhë të parë për Veriun e Shqipërisë në rrethet e Shkodrës, të Malësisë së Madhe, të Lezhës

dhe të Mirditës, por veshjet shfaqen tek-tuk edhe në zonat e thella të Shqipërisë së Jugut, të Kosovës, të Malit të Zi dhe të Maqedonisë.

Sot këto kartolina mund të jenë: grishje në nostalgji, magjepsje prej së bukurës origjinale, sikurse objekt studimi ose lakmi e koleksionistëve. Duke i rikthyer në trajtim dhe kujtesë, rrekemi të forcojmë lidhjet me të shkuarën dhe vlerat që ata përfaqësuat. Përmes këtyre fotove vjen e shkuara dhe i pëshpërit në vesh të sotmes, ndoshta duke i lënë ndonjë amanet apo përmbushur ndonjë premtim, por edhe për t’u mburrur për atë çfarë ajo ishte dhe misionin që iu besua.

Përfaqësues nga 20 qeveri aleate dhe agjenci kombëtare ushtruan aftësinë e NATO-s për të koordinuar përgjigjet ndaj aktiviteteve të rëndësishme kibernetike keqdashëse që prekin infrastrukturën kritike kombëtare.

Stërvitja, e organizuar nga Çekia, kishte për qëllim të siguronte që mekanizmi Virtual i NATO-s për Mbështetjen e Incidentit Kibernetik (VCISC) të mund të funksionojë me shpejtësi dhe pa probleme. E nisur në Samitin e Vilniusit të vitit 2023, kjo aftësi funksionon si një qendër pastrimi për ndihmën e Aleatëve në rast të një sulmi kibernetik. Nëpërmjet VCISC, NATO lehtëson ndihmën, duke i lidhur ata që kërkojnë mbështetje me homologët e caktuar në vendet e tjera aleate dhe duke ndihmuar në koordinimin e ofertave të mbështetjes si analiza e malware, inteligjenca e kërcënimeve kibernetike dhe mjekësia ligjore dixhitale. Qëllimi është të ndihmojnë aleatët të zbusin ndikimin dhe të rimëkëmben nga aktivitetet e rëndësishme me qëllim të keq. Nisma drejtohet nga aleatët mbi baza vullnetare, duke përdorur asetet kombëtare.

Aktivitetet keqdashëse kibernetike janë rritur me kalimin e kohës, duke synuar ndër të tjera: infrastrukturën kritike, sistemet e kontrollit industrial dhe shërbimet qeveritare - për të prishur shoqëritë, për të vjedhur inteligjencën ose për të penguar aktivitetet ushtarake. Pushtimi i plotë i Ukrainës nga Rusia në vitin 2022 nxori në pah shkallën në të cilën kiberneti tani është pjesë e konfliktit modern, si përpara ashtu edhe krahas armiqësive kinetike.

Qasja e NATO-s ndaj mbrojtjes kibernetike

Hapësira kibernetike është e kontestuar në çdo kohë pasi aktorët keqdashës kërkojnë gjithnjë e më shumë të destabilizojnë Aleancën duke përdorur aktivitete dhe fushata keqdashëse kibernetike. Kundërshtarët e mundshëm kërkojnë të degradojnë infrastrukturën tonë kritike, të ndërhyjnë në shërbimet tona qeveritare, të nxjerrin inteligjencë, të vjedhin pronën intelektuale dhe të pengojnë aktivitetet tona ushtarake. Lufta e agresionit të Rusisë kundër Ukrainës ka nxjerrë në pah shkallën në të cilën aktivitetet kibernetike janë një tipar i konfliktit modern. Rusia gjithashtu ka intensifikuar veprimet e saj hibride kundër aleatëve dhe partnerëve të NATO-s, duke përfshirë edhe aktivitetet kibernetike keqdashëse. Ambiciet e deklaruara të Kinës dhe politikat shtrënguese sfidojnë interesat, sigurinë dhe vlerat e NATO-s. Operacionet malinje hibride dhe kibernetike të Kinës, si dhe retorika konfrontuese dhe dezinformimi, synojnë aleatët dhe dëmtojnë sigurinë e NATO-s. Aleatët po kundërshtojnë në mënyrë aktive numrin në rritje të kërcënimeve kibernetike thelbësore dhe të vazhdueshme – duke përfshirë sistemet e tyre demokratike dhe infrastrukturat kritike – duke përfshirë këtu ku ky aktivitet është pjesë e fushatave hibride.

Zhvillimi i aftësisë së NATO-s për mbrojtjen kibernetike

Qendra e Sigurisë Kibernetike e NATO-s (NCSC), e bazuar në Shtabin Suprem të Fuqive Aleate në Evropë (SHAPE) në Mons, Belgjikë, mbron vetë rrjetet e NATO-s, duke ofruar mbështetje të centralizuar dhe gjatë gjithë orarit të mbrojtjes kibernetike. Kjo aftësi evoluon në mënyrë të vazhdueshme dhe ruan ritmin me kërcënimin që ndryshon me shpejtësi dhe mjedisin teknologjik.

NATO ka krijuar gjithashtu një Qendër të Operacioneve të Hapësirës Kibernetike në Mons, Belgjikë. Qendra mbështet komandantët ushtarakë me vetëdije për situatën për të informuar operacionet dhe misionet e Aleancës. Ai gjithashtu koordinon aktivitetin operacional të NATO-s në hapësirën kibernetike, duke siguruar lirinë për të vepruar në këtë fushë dhe duke i bërë operacionet më elastike ndaj kërcënimeve kibernetike.

Në Samitin e NATO-s të vitit 2024 në Uashington DC, krerët e shteteve dhe qeverive ranë dakord të themelojnë Qendrën e re të Mbrojtjes Kibernetike të Integruar të NATO-s – e vendosur në SHAPE – për të përmirësuar mbrojtjen e rrjetit, ndërgjegjësimin e situatës dhe zbatimin e hapësirës kibernetike si një fushë operationale gjatë kohës së paqes, krizave dhe konflikteve. Ata gjithashtu u zotuan të zhvillojnë një politikë për të rritur sigurinë e rrjeteve të NATO-s.

Për të lehtësuar një qasje të përbashkët në mbarë Aleancën për zhvillimin e aftësive të mbrojtjes kibernetike, NATO përcakton gjithashtu objektivat për zbatimin e aftësive kombëtare të mbrojtjes kibernetike nga vendet aleate nëpërmjet Procesit të Planifikimit të Mbrojtjes së NATO-s.

Rritja e kapacitetit të mbrojtjes kibernetike të NATO-s

Mbrojtja kibernetike ka të bëjë po aq me njerëzit sa edhe me teknologjinë. NATO vazhdon të përmirësojë gjendjen e mbrojtjes së saj kibernetike përmes edukimit,

ALEATËT, KOORDINIM TË MBËSHTETJES SË NDËRSJELLË KIBERNETIKE PËRMES NATO-S



trajnimin dhe ushtrimeve.

NATO kryen stërvitje të rregullta, të tilla si Stërvitja vjetore e Koalicionit Kibernetik, dhe synon të integrojë elemente dhe konsiderata të mbrojtjes kibernetike në të gjithë gamën e stërvitjeve të Aleancës, duke përfshirë Ushtrimin e Menaxhimit të Krizave (CMX). NATO po rrit gjithashtu aftësitë e saj për arsimim dhe trajnim, duke përfshirë Gamën Kibernetike të NATO-s, e cila është e bazuar në një strukturë të ofruar nga Estonia. Në nëntor 2023, NATO mbajti Konferencën e parë gjithëpërfshirëse të NATO-s për Mbrojtjen Kibernetike në Berlin, duke bashkuar vendimmarrësit në nivelet politike, ushtarake dhe teknike.

NATO ka një sërë mjetesh praktike për të rritur ndërgjegjësimin e situatës dhe për të lehtësuar shkëmbimin e informacionit, duke përfshirë pikat e kontaktit me autoritetet kombëtare të mbrojtjes kibernetike në të gjitha kryeqytetet aleate. Një Memorandum Mirëkuptimi i dedikuar (MOU) përcakton marrëveshjet për shkëmbimin e një sërë informacionesh dhe asistencë në lidhje me mbrojtjen kibernetike për të përmirësuar aftësitë e parandalimit, elasticitetit dhe reagimit të incidenteve kibernetike.

Informacioni teknik shkëmbehet gjithashtu përmes Platformës së Ndarjes së Informacionit të Malware të NATO-s, e cila lejon që treguesit e kompromisit të ndahen me shpejtësi midis mbrojtësve kibernetikë aleatë, duke përforcuar qëndrimin e përgjithshëm të mbrojtjes së Aleancës.

Qendra e Ekselencës për Mbrojtjen Kibernetike të NATO-s (CCDCOE) në Talin, Estoni është një qendër shumëkombëshe dhe ndërdisiplinore e mbrojtjes kibernetike e akredituar nga NATO për ekspertizë të njohur dhe fokusohet në edukimin, konsultimin, mësimet e nxjerra dhe kërkimin dhe zhvillimin e mbrojtjes kibernetike. Nuk është pjesë e Strukturës së Komandës së NATO-s.

Akademia e NATO-s e Komunikimeve dhe Informacionit (NCI) në Oeiras, Portugali ofron trajnime për personelin nga vendet aleate (si dhe jo-NATO) në lidhje me funksionimin dhe mirëmbajtjen e sistemeve të komunikimit dhe informacionit të NATO-s. Akademia NCI ofron gjithashtu trajnime dhe edukim për mbrojtjen kibernetike.

Shkolla e NATO-s në Oberammergau, Gjermani kryen edukim dhe trajnim në lidhje me mbrojtjen kibernetike për të mbështetur operacionet, strategjinë, politikën, doktrinën dhe procedurat e Aleancës.

Koleji i Mbrojtjes i NATO-s në Romë, Itali nxit të menduarit strategjik për çështjet politiko-ushtarake, duke

përfshirë çështjet e mbrojtjes kibernetike.

Bashkëpunimi me partnerët

Kërcënimet kibernetike sfidojnë kufijtë shtetërorë dhe kufijtë organizativë, kështu që NATO angazhohet me një numër vendesh partnere dhe organizata të tjera ndërkombëtare për të rritur sigurinë e përbashkët.

Angazhimi me vendet partnere bazohet në vlerat e përbashkëta dhe qasjet e përbashkëta për mbrojtjen kibernetike. Kërkesat për bashkëpunim me Aleancën trajtohen rast pas rasti.

NATO gjithashtu punon, ndër të tjera, me Bashkimin Evropian (BE), Kombet e Bashkuara (OKB) dhe Organizatën për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë (OSBE).

Mbrojtja kibernetike është një nga fushat e bashkëpunimit të forcuar midis NATO-s dhe BE-së si pjesë e përpjekjeve gjithnjë e më të koordinuara të dy organizatave për të luftuar kërcënimet hibride. NATO dhe BE ndajnë informacione ndërmjet ekipeve të reagimit kibernetik dhe shkëmbejnë praktikatat më të mira. Bashkëpunimi po përmirësohet gjithashtu në fusha duke përfshirë trajnimin, kërkimin dhe ushtrimet, me rezultate të prekshme në luftën kundër kërcënimeve kibernetike. Marrëveshja Teknike për Mbrojtjen Kibernetike ndërmjet Aftësisë për Reagim ndaj Incidenteve Kompjuterike të NATO-s (tani e njohur si Qendra e Sigurisë Kibernetike e NATO-s) dhe Ekipit të Reagimit ndaj Emergjencave Kompjuterike për institucionet, organet dhe agjencitë e BE-së (CERT-EU) ofron një kornizë për shkëmbimin e informacionit dhe ndarjen e praktikave më të mira ndërmjet ekipeve të reagimit ndaj emergjencave.

Në Samitin e NATO-s 2023 në Vilnius, aleatët u angazhuan të kërkojnë më tej të zhvillojnë partneritete reciproke të dobishme dhe efektive, duke përfshirë me vendet partnere, organizatat ndërkombëtare, industrinë dhe akademinë.

Bashkëpunimi me industrinë

Sektori privat është një lojtar kyç në hapësirën kibernetike dhe risitë teknologjike dhe ekspertiza nga sektori privat janë thelbësore për t'i mundësuar NATO-s dhe aleatëve që t'i përgjigjen në mënyrë efektive kërcënimeve kibernetike.

Në përputhje me konceptin e vitit 2023 për të rritur kontributin e mbrojtjes kibernetike në parandalimin dhe qëndrimin e përgjithshëm të mbrojtjes të NATO-s, siç u miratua nga aleatët në Samitin e Vilniusit 2023, NATO dhe aleatët e saj po punojnë për të forcuar angazhimin e tyre me industrinë dhe akademinë përmes shkëmbimit të informacionit, stërvitjeve, trajnimit dhe edukimit.



KAPITEN (P) VERI TALUSHLLARI

Njëherë “Skënderbegas” – Përgjithmonë “Skënderbegas”

Shkolla “Skënderbej” nuk ishte vetëm një institucion arsimor, ajo ishte një vatrë edukimi, një përgatitje për jetë dhe për shërbim ndaj atdheut. Sot, ndërsa kujtojmë ata që kanë dalë nga kjo shkollë, rikujtojmë gjithashtu vlerat që ajo mbolli: atdhedashurinë, ndershmërinë, guximin dhe sakrificën.

Ky aktivitet është një shenjë mirënjohjeje për rrugën që kanë përshkuar, për gjurmët që kanë lënë dhe për frymëzimin që vazhdojnë të japin brezave të rinj.

Ka disa lidhje që koha nuk i zbeh, dhe disa njerëz që mbeten përgjithmonë të gdhendur në kujtesë – shokët e shkollës “Skënderbej” janë pikërisht të tillë. Ishin të rinj, me ëndrra të mëdha dhe me uniformën që i bënte të ndiheshin pjesë e diçkaje më të madhe se vetja.

Aty, mes disiplinës ushtarake dhe lodhjes së përditshme, u farkëtuan miqësi që nuk i shkriu as largësia, as vitet. Kjo është historia e djemve, e shokëve të bankës, të fjetores, të apelit dhe të stërvitjes. Për ata që ndanin bukën, sekretet dhe ëndrrat.

Nuk janë thjesht kujtime, janë dëshmi e një kohe kur fjala “vëllazëri” kishte peshë dhe kuptim.

Këtë sjell dhe ish-skënderbegasi Veri Talushllari nëpërmjet kujtimeve të tij nga dita e 80-vjetorit të krijimit të shkollës “Skënderbej”. Një aktivitet i organizuar në ambientet e kinemasë së Garnizonit “Skënderbej” dhe ku Veri erdhi prej Amerikës së largët për të takuar bashkudhëtarët e tij ndër vite.

Mallin, dashurinë dhe mirënjohjen ai e shpreh, ashtu siç dinë veç njerëzit e dalë nga bankat e kësaj shkolle model.

Marinsat amerikanë kanë një kredo të tyre: Njëherë Marins - përgjithmonë Marins! Ata e mbajnë atë emër me krenari edhe kur nuk janë më në detyrë.

E nëse do të kërkonim të ngjashmit e tyre mes ushtarakëve shqiptarë, jam i bindur se jemi ne, skënderbegasit.

Ja, erdhi 28 marsi 2025. Kjo ditë shënoi 80-vjetorin e çeljes së Shkollës sonë. Dhe ne, skënderbegasit, që nga ish-komandanti i saj, Mikail Vaso e deri tek të diplomuarit të fundit në ato ditë të trishta të 1992-shit, mblidhemi për të thënëse po, ishim dhe jemi skënderbegas!

Jeta e solli që udhën më të gjatë për të ardhur tek kjo portë ta bëja unë dhe mësuesi im, një nga ikonat e Shkollës, vrapuesi i palodhur Besnik Kurshumi. U nisëm nga Nju Jorku dhe Bostoni, por ato 8 mijë e ca kilometra i bëmë vërtet pa u lodhur, të gatshëm, siç këshilloi profesor Besniku nga skena e kinemasë sonë të dashur, ku mori me të drejtë një Mirënjohje nga Ministri i Mbrojtjes, për të vrapuar edhe në vitet e dekadat që vijnë. Po sigurisht edhe të tjerë sivëllezër kanë ardhur nga larg. Ja, shoku im i klasës, Gëzim Bejko, ka ardhur nga Athina.

Ende pa hyrë në mjediset e Garnizonit “Skënderbej” më thërret një zë i njohur. Është vërtet gëzim të takosh Agim Matrakun, pilotin e talentuar, por mbi të gjitha njeriun e mrekullueshëm, ushtarakun me integritet e dinjitet. Agimi është personazh i një romani, “Mig-19-97”, ku trillimi nga e vërteta nuk kuptohet ku ndahen. Ne që



kemi qenë nën komandën e tij në ato ditë e net të jashtëzakonshme të marsit 1997, e dimë ç’ ka mbajtur mbi shpatulla komandanti ynë për të bërë Detyrën, për të ruajtur Nderin, për t’i shërbyer siç ish betuar Atdheut. Dhe sot, bashkë me një legjendë tjetër të Aviacionit Luftarak Shqiptar, kolonel Shefqet Latën, dhe shokë të tjerë, vjen në Shkollën ku u rrit dhe mori atë forcë morale e fizike për të përballuar detyrat që iu ngarkuan.

Ja dhe Kujtim Boriçi dhe Maksim Fejzullai. Bashkë dhe këtu, si në kopertinën e librit - monument “Skënderbegasit ndër vite”. Takohemi me mall, flasim për vëllimin e 5-të të këtij seriali, por koha është e pamjaftueshme dhe pastaj ku të lënë heronjtë e atyre librave, ata që faqe pas faqeje i mbushën ata, jo me germa, por me jetën e tyre. Sa takoj shokët e mi të Regjimentit KA të Kuçovës, Fatmir Bashollin e Shkëlqim Dervishin, një dorë e ngrohtë më rreh shpatullat. Është Hamit Gojani, Presidenti i SHKURSH-it i shoqëruar nga Arben Mollaj, sekretari i Shoqatës. Me Shoqatën tonë, të ushtarakëve të liruar e në pension, që i kemi vënë emrin “Skënderbej”

në Nju Jork, kemi pasur një bashkëpunim shumë të mirë e tani bisedojmë për plane të reja. Arbeni thotë se kemi përgatitur edhe disa Certifikata Mirënjohjeje për anëtarë të Shoqatës sonë, e kjo më befason.

Po vjen ora për ceremoninë zyrtare, por në kinema nuk mund të hyj pa takuar një zonjë të nderuar, Anjezën, Drejtoreshen e Shtypit Ushtarak. Kemi më se dy vjet që bashkëpunojmë për gazetën “Ushtria” dhe revistën “Mbrojtja”, por u desh kjo festë të takoheshim. Anjeza më fton për një kafe në zyrën e saj, e me thënë të drejtën u ndjeva i privilegjuar.

Ja dhe salla e famshme e kinemasë, karriget, muret... Ja skena ku kemi parë Hyni Milloshin të recitonte me aq pasion poemën mbase më të bukur të shkruar për skënderbegasit, “Vatra e Kuqe”. Aty ka kënduar Tonin Tërshana e sa artistë të tjerë. U ngjita dhe unë 50 vjet më parë për të shoqëruar në një bisedë me skënderbegasit Artistin e Popullit Sandër Prosi. “Shkollë e bukur!, - më tha pas bisedës. - Më kënaqët sot, më mësuar shumë gjëra”.

Salla mbushet me tingujt e Himnit Kombëtar e të gjithë jemi në këmbë me dorën në zemër. Pranë kam Bujar Hasanin, presidentin e parë të Shoqatës sonë, që tashmë është kthyer të jetojë në Shqipëri.

Pastaj përshëndetjet, ndahen certifikata mirënjohjeje e më pas fotoja tradicionale. Nuk e humbas rastin kur takoj Ministrin e Mbrojtjes për ta ftuar të takohet me

Shoqatën tonë, kur të vijë në Nju Jork. Gjë që premtoi ta bëjë.

Ja dhe komandant Bashkim Bregu, pak më tej Skënder Doda, ja Luan Pashollari, i buzëqeshuri Aleksandër Haxhiaj... Sa do të doja të qëndroja mes tyre, por ku të lënë Pashk Reçi dhe Astrit Alija, që kanë organizuar takimin e klasës sonë te “Fresku”. Aty rreth tavolinës mblidhemi me Perlat Binajn dhe Gëzin Dedën, Lefter Kacabanin, Fatos Beqirin e Mark Shabakun, e më pas na bashkohen edhe Kujtim Cuka e Bujar Luzi. Në krye të vendit kemi vënë profesorin tonë të matematikës, Asimaq Prokon. 3-4 orë të paharruara, me aq shumë humor e kujtime, kaluan si të ishin minuta.

E në të vërtetë e gjithë kjo festë kaloi shpejt, por tek të gjithë ne skënderbegasit pati efektin e një stuhie. Zgjoi shumë kujtime, hapi shumë diskutime e shkaktoi shumë debate. Si për të thënë se shpirti skënderbegas kurrë nuk fle. Deri sa të rrahë zemra e skënderbegasit të fundit. Po deri atëherë do të kemi rast të mblidhemi në përvjetorë të tjerë.

Si po e Formojnë Luftën Tokësore Mjetet Luftarake Robotike të Gjeneratës së Ardhshme

Në peizazhin gjithnjë në ndryshim të operacioneve ushtarake moderne, ku superioriteti teknologjik shpesh përcakton suksesin, automjetet luftarake robotike (RCV) janë shfaqur si mjete transformuese. Këto sisteme autonome, të projektuara për të performuar në disa nga mjediset më të ashpra të botës, janë të vendosura të ripërcaktojnë dinamikën e luftës tokësore. Ndërsa ushtritë në të gjithë botën investojnë në zgjidhje të përparuara për të përmbushur kërkesat e fushave të betejës së shekullit të 21-të, Ushtria Amerikane po udhëheq avancimin me prova pionere që shfaqin potencialin e RCV-ve.

Ndër shembujt më të spikatur të këtyre sistemeve është “Milrem Robotics Themis”, i zhvilluar në Estoni nga “Milrem Robotics”. Ky automjet modular është ndërtuar për misione shumëfunksionale dhe mund të mbajë ngarkesa deri në 1,200 kg. Ai mbështet sisteme të ndryshme armësh me telekomandë për të ndihmuar trupat tokësore ose për të kryer zbulim në mjedise armiqësore. Themis është përdorur tashmë nga ushtri të shumta evropiane, duke përfshirë edhe gjatë operacioneve në Arktik dhe në pyje.

Një shembull tjetër i rëndësishëm është “Ripsaw M5”, i projektuar nga “Textron Systems” në Shtetet e Bashkuara. Ky RCV shumë i lëvizshëm mund të integrojë module të ndryshme luftimi për misione që variojnë nga zbulimi dhe transporti logjistik deri te sulmet direkte. Me shpejtësinë e tij mbresëlënëse dhe armaturën e lehtë, “Ripsaw M5” është i pajisur me një sistem armësh në distancë dhe radar për zbulimin e objektivave dhe mbrojtjen e forcës. Aktualisht, duke kaluar teste në kuadër të programit të Automjeteve Luftarake të Gjeneratës së Ardhshme të Ushtrisë Amerikane, ai ka demonstruar përshtatshmëri ndaj skenarëve kompleksë.

Uran-9 i Rusisë, i zhvilluar nga “Kalashnikov Concern”, është një tjetër ilustrim i integritetit të RCV në forcat ushtarake moderne. I projektuar për role të drejtpërdrejta luftimi, ai përmban një top automatik 30 mm, raketa antitank dhe një sistem mbrojtjeje kundër këmbësorisë. Megjithatë vendosja e tij në Siri zbuloi probleme komunikimi, Uran-9 përfaqëson një hap të rëndësishëm përpara në shfrytëzimin e automjeteve autonome për angazhimet në fushën e betejës.

Në Izrael, “Jaguar UGV”, i krijuar nga “Israel Aerospace Industries”, ilustron aftësitë e mbikëqyrjes dhe patrullimit të kufijve. I pajisur me sensorë të përparuar, si armë vdekjeprurëse ashtu edhe jo-vdekjeprurëse, dhe navigim autonom, ky automjet siguron zona me rrezik të lartë, duke zvogëluar ekspozimin e ushtarëve ndaj kërcënimeve. “Jaguar UGV” është aktualisht i vendosur përgjatë kufijve të Izraelit, duke kryer në mënyrë efektive operacione mbikëqyrjeje dhe mbrojtëse.

Kina, një tjetër lojtar i madh në zhvillimin e sistemeve robotike, ka prezantuar “Sharp Claw 1”, të zhvilluar nga NORINCO. Ky automjet kompakt me zinxhirë është i specializuar në misione zbulimi dhe patrullimi. I pajisur me një mitraloz dhe sisteme të avancuara mbikëqyrjeje, është demonstruar në ushtrime ushtarake, duke shfaqur aftësinë e tij për të vepruar në terren sfidues. Në mënyrë të ngjashme, HR-Sherpa e Koresë së Jugut, e zhvilluar nga “Hyundai Rotem”, përqendrohet në mbështetjen logjistike, duke transportuar ngarkesa të rënda në mënyrë autonome për të furnizuar trupat në zonat e luftimit.

Zhvillimi i RCV-ve nuk është vetëm një moment historik teknologjik, por një ndryshim strategjik në mënyrën se si ushtritë planifikojnë dhe ekzekutojnë operacionet. Duke kombinuar inteligjencën artificiale të përparuar, teknologjinë e telekomandës dhe dizajnet mekanike të ashpra, këto platforma marrin role që tradicionalisht rezervoheshin për automjetet e pilotuara. Nga mbështetja logjistike dhe zbulimi deri te angazhimi në luftime të drejtpërdrejta, RCV-të janë ndërtuar për të zvogëluar rreziqet për ushtarët njerëz, duke rritur njëkohësisht efikasitetin operacional. Testet kanë demonstruar aftësinë e tyre për të përshkuar terren të thyer, për të identifikuar kërcënimet në mënyrë autonome dhe për të përfunduar misione komplekse me mbikëqyrje minimale njerëzore.

Një avantazh kryesor i RCV-ve qëndron në aftësinë e tyre për të vepruar në mjedise me rrezik të lartë, ku viktimat njerëzore përndryshe do të ishin të pashmangshme. Për shembull, në zonat urbane të luftimit, RCV-të mund të bëjnë zbulime përpara, duke u ofruar inteligjencë në kohë reale komandantëve pa vënë në rrezik jetën e njerëzve. Aftësia e tyre për t’u angazhuar në objektiva në mënyrë autonome lehtëson vendimmarrjen e shpejtë në situata kritike, dhe aftësitë e tyre të mbështetjes logjistike zgjerojnë shtrirjen operacionale, duke u dërguar furnizime njësisë në zona



të izoluar ose armiqësore.

Për më tepër, RCV-të po riformësojnë doktrinën ushtarake, duke përmirësuar koordinimin midis njësisë me dhe pa pilot. Sipas programit të Automjeteve Luftarake të Gjeneratës së Ardhshme, Ushtria Amerikane ka testuar me sukses prototipa që integrohen pa probleme me njësitë e drejtuara nga njeriu. Këto prova treguan se si RCV-të mund të ofrojnë mbështetje kritike, të tilla si përballja me kërcënime ose zbulimi, duke i liruar ushtarët njerëzorë të përqendrohen në detyra strategjike.

Rritja e RCV-ve ka gjithashtu implikime të rëndësishme për industrinë e mbrojtjes. Kontraktorët kryesorë të mbrojtjes në të gjithë botën po investojnë në sisteme robotike, duke krijuar një peizazh konkurrues për inovacion. Kompani si “Textron Systems”, “Kalashnikov Concern” dhe “Milrem Robotics” kanë fituar një pikëmbështetje në këtë treg në lulëzim, ndërsa të tjera si “Rheinmetall” në Gjermani dhe “Hyundai Rotem” në Korenë e Jugut po përparojnë me shpejtësi teknologjike të tyre të RCV-ve.

Për qeveritë, integrimi i RCV-ve kërkon balancimin e avantazheve të menjëhershme të aftësive të përmirësuara me kostot afatgjata të blerjes, mirëmbajtjes dhe menaxhimit të ciklit jetësor. Zhvillimi i këtyre automjeteve stimulon industrinë vendase të mbrojtjes dhe krijon mundësi për bashkëpunim ndërkombëtar.



Për shembull, “Milrem Robotics” e Estonisë është partnerizuar me shumë vende të NATO-s për të rafinuar platformën TheMIS, ndërsa firmat amerikane si “Textron Systems” po sigurojnë kontrata për të përmbushur nevojat e aleatëve dhe partnerëve globalisht.

Shembujt e “Themis”, “Ripsaw M5”, “Uran-9”, “Jaguar UGV” dhe sistemeve të tjera nxjerrin në pah rolet e ndryshme që RCV-të janë gati të luajnë në riformësimin e luftimeve tokësore. Duke përmirësuar ndërgjegjësimin për situatën, duke zvogëluar viktimat dhe duke rritur efektivitetin e misionit, këto automjete kanë potencialin të bëhen asete të domosdoshme në operacionet ushtarake. Megjithatë, realizimi i potencialit të tyre të plotë kërkon adresimin e sfidave të tilla si besueshmëria, komunikimet e sigurta dhe integrimi i përsosur në strukturat ushtarake.

Ndërsa ushtritë në mbarë botën vazhdojnë të eksplorojnë aftësitë e sistemeve robotike, ndikimi i RCV-ve në luftën tokësore padyshim do të zgjerohet. Zhvillimi i tyre nënkupton jo vetëm inovacionin teknologjik, por edhe një ndryshim më të gjerë në mënyrën se si do të luftohen dhe zgjidhen konfliktet në dekadat që do të vijnë. Për Ushtrinë Amerikane dhe aleatët e saj, udhëtimi drejt operacionalizimit të RCV-ve ka të bëjë po aq shumë me kuptimin e së ardhmes së luftimit, sa edhe me ndërtimin e makinerive që do ta përcaktojnë atë.

Gjuhët indo-evropiane, një pemë gjenealogjike gjuhësore që ndryshoi botën

Familja gjuhësore indo-evropiane është një nga më me ndikim dhe më të përhapurat në historinë e njerëzimit. Nga qytetërimet e lashta të Indisë dhe Greqisë deri te gjuhët moderne globale si anglishtja dhe spanjishtja, këto gjuhë kanë formësuar kulturat, shoqëritë dhe komunikimin në mbarë botën. Duke u shtrirë në mijëra vjet, gjuhët indo-evropiane janë evoluuar dhe diversifikuar në degë të shumta, duke lënë pas një ndikim të thellë në letërsi, shkencë, filozofi dhe jetën e përditshme.

Origjina e gjuhëve indo-evropiane

Gjuhët indo-evropiane i kanë rrënjët e tyre në gjuhën prehistorike proto-indo-evropiane (PIE), të folur nga njerëzit e hershëm rreth 4,500 deri në 6,000 vjet më parë, me shumë mundësi në rajonin e stepave euroaziatike.

Gjuha Proto-Indo-Europiane (PIE) shpesh mendohet si paraardhësja gjuhësore e një familjeje të gjerë gjuhësh të folura në të gjithë Evropën, Azinë Jugore dhe pjesë të Lindjes së Mesme. Duke gjurmuar rrënjët e saj në stepat euroaziatike, veçanërisht zonat përreth Stepës Pontike-Kaspikë (Ukraina e sotme dhe Rusia jugore), PIE na jep një pamje interesante të jetës së folësve të saj - njerëzve të hershëm që jetuan mijëra vjet më parë.

Nga PIE, dolën degë të shumta, duke përfshirë gjermaniken, italiken, indo-iraniane, balto-sllave, helenike dhe të tjera. Sot, këto degë janë zhvilluar në gjuhë si anglishtja, shqipja, hindishteja, greqishtja, spanjishtja dhe shumë të tjera.

Gjuha proto-indo-evropiane

Gjuha PIE është paraardhësi i përbashkët i rindërtuar i të gjitha gjuhëve indo-evropiane. Gjuhëtarët nxjerrin strukturën, fjalorin dhe fonetikën e saj nëpërmjet krahasimit të gjuhëve pasardhëse që ende ndajnë tipare të përbashkëta.

Gjuha Proto-Indo-Evropiane (PIE) është “lidhja” origjinale që bashkon të gjitha gjuhët indo-evropiane. Duke krahasuar gjuhët pasardhëse, gjuhëtarët kanë rindërtuar pjesë të strukturës, fjalorit dhe fonetikës së PIE-së. Studimi i saj na ka mundësuar të kuptojmë konceptet kulturore, mënyrën e jetesës dhe botëkuptimin e folësve të saj të lashtë.


Gjuhët pasardhëse, si shqipja, anglishtja, hindi, greqishtja dhe të tjera, kanë trashëguar elemente që na lejojnë të gjurmojmë përputhjet në mes të tyre.



Përhapja e gjuhëve indo-evropiane

Përhapja e gjuhëve indo-evropiane ndodhi nëpërmjet migrameve, pushtimeve dhe shkëmbimeve kulturore. Ndërsa popullatat lëviznin nëpër Evropë, Azi dhe Lindjen e Afërt, ato i mbartnin me vete gjuhët e tyre.

Përhapja e gjuhëve indo-evropiane është një shembull i fuqishëm i ndikimit që migrimet dhe ndërveprimet kulturore kanë në zhvillimin gjuhësor. Migrimet e hershme nga stepat



e Pontit-Kaspik (sipas hipotezës Kurgane) i çuan këto gjuhë në pjesë të Evropës dhe Azisë. Ndërkohë, shkëmbimet kulturore, tregtia dhe pushtimet kontribuan në përhapjen dhe evoluimin e këtyre gjuhëve.

Gjuhët indo-evropiane filluan të ndryshojnë ndërsa popullatat u përshtatën me kushtet lokale, duke zhvilluar variante rajonale dhe dialekte që përfundimisht u bënë degë të ndryshme, si gjuhët gjermanike, italike, indo-iraniane, balto-sllave, etj. Ky proces evolutiv i dha formë mozaikut të gjuhëve që ne flasim sot.

Atdheu indo-evropian

Atdheu origjinal i folësve të gjuhës indo-evropiane hipotetizohet të jetë stepa pontiko-kaspikë, në veri të Detit të Zi. Prej andej, ata u shpërndanë nëpër rajone të gjera gjatë mijëvjeçarëve.

Sipas hipotezës Kurgane, kjo zonë, e cila ndodhet në veri të Detit të Zi, ishte vendbanimi i popujve që flisnin Proto-Indo-Evropianisht. Ata filluan të shpërndaheshin nëpër rajone të gjera që përfshijnë Evropën, Azinë dhe Lindjen e Afërt gjatë mijëvjeçarëve, duke u përshtatur dhe zhvilluar gjuhët pasardhëse.

Shtrirja e këtyre gjuhëve lidhet ngushtë me migrimet, zhvillimet teknologjike si përdorimi i kalit dhe qerreve, dhe shkëmbimet kulturore. Pavarësisht nga teoritë alternative si hipoteza Anatoliane, përhapja e gjuhëve indo-evropiane mbetet një temë e pasur për kërkime dhe eksplorime.

Familjet gjuhësore

Indo-evropiane ndahet në disa degë: balto-sllave, gjermanike, romane, kelte, indo-iraniane, helene dhe të tjera. Secila degë ka zhvilluar gjuhë të dallueshme, por ato ndajnë prejardhje të përbashkët gjuhësore.

Familja gjuhësore indo-evropiane është e organizuar në degë që përfshijnë një shumëllojshmëri gjuhësh të pasura dhe të dallueshme. Ja një përmbledhje e disa prej degëve kryesore:

- Balto-Sllave: Përfshin gjuhët baltike (si lituanishtja dhe letone) dhe sllave (si rusishtja, polonishtja dhe serbokroatishtja).
- Gjermanike: Përfshin gjuhë si anglishtja, gjermanishtja, dhe suedishtja.
- Romane: E njohur për gjuhë si italishtja, spanjishtja, frëngjishtja, dhe rumanishtja.
- Kelte: Përfshin gjuhët tradicionale si irlandishtja, uellsishtja dhe skotis-galishtja.
- Indo-Iraniane: Një degë e gjerë që përfshin gjuhë si hindi, urdu, persishtja, dhe pashto.
- Helene: Përbëhet nga greqishtja, që ka një histori të pasur dhe të lashtë.
- Shqiipe: Përbën një degë unike brenda indo-evropianes, me një histori të veçantë.

Këto degë ndajnë një prejardhje të përbashkët që reflektohet në strukturat gramatikore, fjalorin dhe tingullin bazë, edhe pse evolucioni i mëtejshëm i ka formësuar ato në mënyra të ndryshme.

Sistemi tingullor Proto-Indo-Evropian

PIE kishte një sistem kompleks bashkëtingëlloresh dhe zanoresh. Përmes rindërtimit gjuhësor, studiuesit kanë identifikuar një sërë bashkëtingëlloresh, duke përfshirë ndalesat, fërkimet dhe hundoret, që ndikuan në gjuhët e mëvonshme.

Gramatika indo-evropiane

Gjuhët indo-evropiane njihen për morfologjinë e tyre të



lakimit. Fjalët ndryshojnë formën e tyre në varësi të rolit që kanë në një fjali; emrat, mbiemrat dhe foljet mund të kenë rasa, kohë dhe gjini të ndryshme.

Mitologjia Indo-Europiane

Shumë kultura të lashta Indo-Europiane kanë ngjashmëri në mitologjinë e tyre. Zotat dhe ritualet shpesh pasqyrojnë tema të ngjashme, siç janë perënditë e qiellit, perënditë e diellit dhe ritualet e zjarrit, duke treguar lidhje kulturore midis tyre.

Ngritja e degës indo-iraniane

Dega indo-iraniane, e cila përfshin gjuhë si sanskritishtja dhe persishtja, u përhap në të gjithë Azinë Jugore dhe Iranin. Ndikimi i saj formësoi tekstet fetare, duke përfshirë Vedat dhe Avestan.

Ndikimi i greqishtes së lashtë

Greqishtja është një nga gjuhët më me ndikim brenda familjes indo-evropiane. Greqishtja klasike ishte themelore në filozofinë, shkencën, letërsinë dhe mendimin politik perëndimor, duke lënë një trashëgimi në gjuhët moderne.

Latinishtja dhe Perandoria Romake

Latinishtja, e folur nga Romakët, u përhap në të gjithë Evropën me Perandorinë Romake. Ndërsa perandoria u zgjerua, latinishtja evoluoi në gjuhët romane, të tilla si spanjishtja, frëngjishtja, italishtja, portugalishtja dhe rumanishtja.

Përhapja e gjuhëve romane në botë

Gjuhët romane, kryesisht spanjishtja, frëngjishtja dhe portugalishtja, u përhapën në të gjithë botën nëpërmjet pushtimeve dhe kolonizimit. Ato ndikuan ndjeshëm në rajone në Amerikë, Afrikë dhe pjesë të Azisë dhe Oqeanisë.

Gjuhët kelte

Dega kelte dikur përfshinte pjesën më të madhe të Evropës, ku gjuhët kelte si irlandishtja, uellsishtja dhe gaelishtja skoceze ishin të përhapura. Sot, ato mbijetojnë në disa rajone, megjithëse ndikimi i tyre është zvogëluar.

Zgjerimi i gjuhëve gjermanike

Gjuhët gjermanike, duke përfshirë anglishten, gjermanishten dhe holandishten, janë gjithashtu një degë e familjes së gjuhëve indo-evropiane. Gjuhët skandinave, si suedishtja, norvegjishtja dhe danezja, dolën gjithashtu nga ky grup dhe u përhapën në të gjithë Evropën Veriore përmes migrimeve të Vikingëve dhe ndikimit të mëvonshëm kulturor.

Gjuhët sllave

Gjuhët sllave, duke përfshirë rusishten, polonishten, çekishten dhe gjuhët ballkanike si serbishtja, kroatishtja dhe bullgarishtja, formojnë një degë të madhe indo-evropiane që flitet në të gjithë Evropën Lindore dhe pjesë të Azisë Qendrore. Ato e gjurmojnë origjinën e tyre te sllavët

e hershëm.

Lidhja balto-sllave

Gjuhët balto-sllave, duke përfshirë lituanishten dhe letonishten, formojnë një degë të dallueshme brenda indo-evropiane. Këto gjuhë fliten në rajonin baltik dhe kanë ruajtur shumë tipare të lashta të PIE-së.

Gjuhë të huaja urale

Finlandishtja, hungarishtja dhe estonishtja janë gjuhë urale, që nuk kanë lidhje me gjuhët indo-evropiane. Ndërsa finlandishtja dhe estonishtja janë të lidhura ngushtë, hungarishtja dallohet me gramatikë dhe fjalor të veçantë, duke e bërë atë edhe më unike.

Gjuhët iraniane

Gjuhët iraniane, pjesë e degës indo-iraniane, përfshijnë persishten, gjuhën kurde dhe pashtunishten. Këto gjuhë kanë evoluar në pllajën iraniane dhe janë thelbësore për të kuptuar historinë e rajonit.

Persishtja vs. Arabishtja

Edhe pse të ndryshme, persishtja dhe arabishtja shpesh ngatërrohen. Persishtja, një gjuhë indo-evropiane, ka gramatikë dhe shkrim më të thjeshtë, ndërsa arabishtja, një gjuhë semite, paraqet gramatikë komplekse dhe një shkrim unik.

Gjuhët indo-evropiane në Indi

Në Indi, gjuhët indo-evropiane, veçanërisht ato të degës indo-ariane, fliten nga mbi një miliard njerëz. Hindishtja, bengalishtja, punjabi dhe guxharatishtja janë ndër më të folurat.

Gjuha shqipe



“Mee ni hemmen zze dessirnnnee e phorte t' Lummnummitt ZOT e mbaronjj n' Vitte MCCX dittn ee IX t' Mmarxxitee” - “Me ndihmën dhe dëshirën e fort të lumturit Zot, e përfundova në vitin 1210, ditën e 9 të marsit”

Gjuha shqipe qëndron si një anëtare interesante e familjes indo-evropiane, sepse është një degë e dallueshme dhe e izoluar, që do të thotë se nuk ka të afërm të ngushtë gjuhësorë. Veçantia e saj i ka intriguar gjuhëtarët për shekuj me radhë.

Shqipja flitet nga miliona njerëz, kryesisht në Shqipëri, Kosovë, Maqedoninë e Veriut, Mal të Zi dhe pjesë të Serbisë jugore dhe Greqisë. Pavarësisht shekujve të ndikimit historik - qoftë përmes kulturave romake, bizantine, osmane apo sllave - ajo ka arritur të ruajë karakteristikat e lashta gjuhësore. Përdor fjalë të huazuara nga gjuhë të tjera, megjithatë ruan gramatikën dhe fjalorin e saj të veçantë.

Regjistrimi më i hershëm i shkruar i shqipes daton që nga shekulli i 15-të, edhe pse vetë gjuha ekzistonte shumë kohë më parë. Megjithatë dorëshkrimi i Teodor Shkodranit nga viti 1210, i tëri në gjuhën shqipe, shtyn kufijtë kohorë për 345 vite më herët se sa “Meshari” i Buzukut, që është i vitit 1555. Gjuha shqipe ka një histori të pasur dhe unike brenda familjes indo-evropiane.

Gjuha armene

Armenishtja, një degë tjetër unike brenda indo-evropiane, është gjuha zyrtare e Armenisë. Ajo ka ruajtur shumë tipare arkaike nga PIE, ndërsa ka evoluar në izolim për shkak të faktorëve gjeografikë dhe politikë.

Romanishtja: një gjuhë indo-ariane

Gjuha romanishte, e folur nga populli rom në të gjithë Evropën, është pjesë e nëngrupit indo-arian të familjes indo-evropiane. Ajo ndan rrënjë gjuhësore me gjuhët e Indisë veriore dhe ka dialekte të shumta rajonale të ndikuara nga gjuhët lokale.

Gjuhët indo-evropiane të zhdukura

Disa gjuhë indo-evropiane, të tilla si tokarishtja, trakishtja e lashtë dhe gjuhët anatoliane të zhdukura (si hititishtja), nuk fliten më sot. Këto gjuhë ofrojnë njohuri të vlefshme mbi kulturat dhe gjuhësinë e lashtë.

Roli i anglishtes në nivel global

Anglishtja, një gjuhë gjermanike me origjinë, është bërë një lingua franca globale nëpërmjet kolonizimit dhe globalizimit. E ndikuar nga latinishtja, frëngjishtja dhe gjuhë të tjera indo-evropiane, ajo është zhvilluar në një gjuhë të pasur dhe të gjithanshme.

Ndikimi i gjuhëve indo-evropiane në gjuhë të tjera

Gjuhët indo-evropiane kanë ndikuar në shumë gjuhë jo-indo-evropiane, shpesh nëpërmjet fjalëve të huazuara. Për shembull, gjuhët urale si finlandishtja dhe hungarishtja kanë përvetësuar fjalë nga gjuhët indo-evropiane gjermanike dhe sllave për shkak të tregtisë, pushtimit dhe kontaktit kulturor.

Evolucioni dhe ndryshimi i gjuhës

Gjuhët indo-evropiane kanë evoluar gjatë mijëvjeçarëve. Ndryshimet tingujore, thjeshtëzimet gramatikore dhe ndryshimet e fjalorit kanë çuar në diversitetin e gjuhëve që shohim sot, secila me rregulla unike fonetike dhe sintaksore.

E ardhmja e gjuhëve indo-evropiane

Ndërsa shumë gjuhë indo-evropiane po lulëzojnë, të tjera janë në rrezik zhdukjeje për shkak të globalizimit dhe ndryshimeve kulturore. Për shembull, gjuha osetiane, e folur në rajonin e Kaukazit të Rusisë dhe Gjeorgjisë, dhe gjuha kashubiane, e folur në Poloninë veriore, po përjetojnë rënie të numrit të folësve.

Për të parandaluar humbjen e mëtejshme të gjuhës, përpjekjet aktive për ruajtjen e saj, duke përfshirë edukimin, dokumentimin dhe përfshirjen e komunitetit, janë thelbësore

për ruajtjen e këtyre traditave të vlefshme gjuhësore.



Prof. Asoc. Dr. Bernard Zotaj

Në kuadrin e 80-vjetorit të rënies së dëshmorë të BrXXVS Luftoi nga Shijaku në Kosovë

Bahri H. Shaqiri lindi në Shijak, më 22 prill 1922. Aty kreu dhe shkollën fillore. Studimet i vazhdoi në Shkodër, në Tiranë, në gjimnaz më 1938, ku u njoh me Qemal Stafën, Manush Alimanin etj. Ishte djalë shtatgjatë e truphollë, me sy të zjarrtë e të qeshur, kishte temperament të gjallë, merrte pjesë në lojërat sportive dhe aktivitetet kulturore-artistike që zhvilloheshin në shkolla, i binte bukur violinës dhe shkruante vargje.

Në Shijak u lidh me Lëvizjen Antifashiste Nacionalçlirimtare, ku si agjikator, shpërndarës i shtypit të Partisë, pjesëmarrës me guerilasit për prerjen e telave telefonikë në korrik 1942, spikati kudo gjakftohtësia, guximi dhe gatishmëria për të bërë çdo sakrificë për çështjen e lirisë së atdheut. Veprimtaria e tij ra në sy të armikut dhe, më 5 korrik 1943, hidhet në rreshtat partizane në forcat e Pezës, në çetën që vepronte në zonën e Shijakut, ku zgjidhet përgjegjës i rinisë në çetë. Në batalionin e parë të Grupit të Pezës, Bahriu u caktua komisar politik kompanie, ku mori pjesë në luftimet në Karpën e në Pezën e Vogël. Në dhjetor 1943 kaloi me detyrë pranë shtabit të Grupit Partizan të Pezës. Në fund të dhjetorit 1943 Bahri Shaqiri u dërgua me detyrë partie në Kosovë. Aty për 10 muaj bëri një punë të madhe me rininë shkollore e me rininë punonjëse në Prishtinë e në Gjakovë.

Në tetor-nëntor 1944, forcat e DVS të Ushtrisë Nacionalçlirimtare Shqiptare, në bashkëpunim me forcat partizane vendase, zhvilluan luftime të ashpra kundër forcave hitleriane e tradhtare në Kosovë. Brigadat shqiptare e ndoqën këmba-këmbës armikun gjatë muajit dhjetor 1944. Në një nga luftimet që zhvilloi kundër armiqve, batalioni ku bënte pjesë Bahriu, u gjend i rrethuar. Duke çarë rrethimin, Bahriu as u tremb, as u tërhoq dhe e vazhdoi luftimin... po nuk kaloi shumë dhe u godit për vdekje. Populli kosovar i bëri nderimet e merituar birrit që dha jetën për çlirimin e tij. Eshtrat e tij në vitin 1976 u prunë në Tiranë dhe janë vendosur në varret e dëshmorëve.

Ja zbardhe faqen plakut...

Hasan Hysen Bardhoshi ishte nga fshati Qarr i Krumës së Hasit të Thatë, i lindur në vitin 1920. Shumë kujtime të sjell ky vend. Malet që e rrethojnë në shekuj kanë shërbyer si çerdhe të luftëtarëve të lirisë dhe të pavarësisë. Nga fshati Qarr qenë nisur forcat e Bajram Currit, në maj të vitit 1924, për të sulmuar qendrën e prefekturës së Kosovës, Krumën. Në luftimet që u zhvilluan për marrjen e Krumës e deri në Kala të Dodës, krah për krah me Bajram Currin mori pjesë dhe i ati i Hasanit, Hyseni, i cili e pat shoqëruar plakun e maleve në çdo betejë. Hasani i vogël, u rrit me jehonën e krismave të armëve në ato vite të stuhishme... Shkollën fillore e kreu në fshatin Golaj, pastaj vazhdoi mësimet në internatin “Kosova” të Krumës dhe në gjimnazin e qytetit të Shkodrës. Këtu Hasani u njoh me gjimnazistë dhe me idetë revolucionare, si me Emin Durakun, Nazmi Rushitin etj. Hasani u aktivizua dhe shpejt veprimtaria e tij ra në sy të autoriteteve, të cilët e përjashtuan nga shkolla. Ai u kthye në Qarr dhe kapi shatin për të punuar si bujk, pa e ndërprerë asnjë çast veprimtarinë e tij revolucionare. Kështu, në krahinën e largët dhe të izoluar të Hasit, punoi me ngulm në dobi të Luftës Nacionalçlirimtare. Hasani ishte një nga partizanët e parë të asaj krahine që hodhi pushkën krahut dhe doli malit për liri. Me formimin e BrXXVS, ai u radhit në rreshtat e saj dhe në të gjitha luftimet u shqua për trimëri të rrallë. Për këto merita shtabi i brigadës e caktoi atë zëvendëskomandant batalioni, për anën ekonomike, detyrë të cilën e kreu deri në fund. Çlirimi i vendit tonë nga pushtuesit nazistë dhe tradhtarët e vendit, për të cilin ëndërronte gjithnjë Hasani, e gjeti atë jashtë kufijve të atdheut duke luftuar në Kosovë dhe në tokat e Jugosllavisë. Ai mori pjesë në të gjitha luftimet e ashpra që zhvilluan partizanët e BrXXVS si në Kosovë, Ferizaj, Pripolje e deri në Sanxhak.

...Ishte janari i vitit 1945. Bënte ftohtë dhe acar i madh. Dëbora e kalonte metrin, megjithatë partizanët çanin përpara. Së bashku me ta luftonte edhe Hasani, i cili sulej me furi duke lëshuar me pushkën e tij plumba mbi kokat e armikut. Në ato ditë të janarit në Sanxhakun malor u zhvilluan shumë luftime, të cilat u kurorëzuan me sukses nga partizanët tanë trima. Në këto luftime të ashpra ra me armë në dorë partizani Hasan Qarri.

Gazeta e xhepit e BrXXVS “Luftëtari i malësisë” shkroi: “Një predhë gjakatare vërsëlleu dhe krisma e saj ushtoi në grykat e

Ranë për t’u kujtuar në vite...



Sanxhakut të mbulue me dëborë. Trupin e partizanit Hasan Hyseni Qarri e kishin dërmue copat e murtajës... Ja edhe një martir i ri. Hasani ra dëshmor në fushën e betejës, këtu në tokat e Sanxhakut, larg atdheut”. Kur i shkoi lajmi nënës së Hasanit për vrasjen e të birit, ajo ligjëroi: “Ti ja zbardhe faqen Plakut,/ Ylli i kuq me pika të gjakut...”. Është shpallur Dëshmor i Atdheut me vendim nr. 104, datë 13.11.1969 të Komitetit Ekzekutiv të KP të rrethit Tropojë.

Kudo luftoi me trimëri

Mushak Kadri Rustemaj kishte lindur në vitin 1921, në fshatin Koçanaj të rrethit të Tropojës. Shkollën fillore e kreu në fshatin Kolgecaj dhe deri në vitin 1941 qëndroi pranë familjes në fshat. Në vitin 1942, gjatë kohës që kryente shërbimin ushtarak, ra në kontakt me shokë të Lëvizjes Antifashiste Nacionalçlirimtare dhe së bashku me një grup shokësh u arratis nga ushtria. Kur u kthye në shtëpi, u bashkua menjëherë me çetën territoriale të Lumit të Gashit. Armiku për aktivitetin e tij revolucionar u përpoq ta zhdukte dhe familjen t’ia persekutonte. Familjarët u detyruan të jetonin për një kohë në Brodozhnicë. Mushaku mori pjesë në disa aksione: si në aksionin në rrugën Pejë-Gjakovë, në Krumë, ku u shkatërrua posta e xhandarmërisë, në Zherkë, ku luftoi trimërisht kundër forcave të shumta të Pashuk Bibës etj. Kudo ai luftoi me trimëri. Në korrik të vitit 1944, u pranua në radhët e PKSH-së dhe me krijimin e Br.XXVS u emërua komisar kompanie. Në këtë periudhë në zonat e Veriut reaksioni vendas grumbullonte forca dhe kërkonte t’i mbante këto nën ndikimin e vet.

Partizanët e Br.XXVS zhvilluan luftime të shpeshta me forcat reaksionare të grumbulluara në Veri si në Theth, Nikaj e Mertur. Në këto përpjekje në rreshtat e para ishte dhe komisar i kompanisë Mushak Rustemaj. Në dhjetorin e vitit 1944 mori pjesë në luftimet e ashpra që zhvilloi brigada jashtë kufijve të Atdheut si në Ferizaj e Judovnik. Vdiq në spitalin partizan të Ivanës, në shkurt të vitit 1945. Është shpallur Dëshmor i Atdheut me vendim nr. 52, datë 04.11.1969 të Komitetit Ekzekutiv të KP të rrethit Tropojë.

Mos më qani...vazhdoni luftën

Qazim Maliq Shehu lindi në Shtiqën të Kukësit më 1918, në një familje patriotë. Kreu shkollën fillore dhe vështirësitë ekonomike të familjes e detyruan të marrë rrugën e kurbetit... e kaliti puna, vuajtjet dhe jeta prej punëtori në Kosovë e Maqedoni. Në dhjetor 1941 pranohet në Partinë Komuniste dhe nisi aktivitetin luftarak. Në Tetovë punonte dhe bëri jetën e një militanti dhe pjesëtari të njësitit gueril. Ai ka marrë pjesë në aksionet e njësitit në marrjen e armëve, në likuidimin e spiunëve, në djegien e depove armike, në marrjen e dokumenteve të komandës gjermane etj. Në kushtet e luftës ilegale, kreu një aktivitet dhe si ndërlidhës i njësiteve partizane të krahinës së Lumës me Kosovën etj.

Në vitin 1943, Qazimi kalon në radhët e brigadave partizane në Kosovë, ku zgjidhet zëvendëskomandant kompanie dhe pas komandant kompanie. Në vitin 1944 kryen detyrën e komandantit të batalionit, duke shfaqur aftësi, trimëri, shkathtësi dhe mprehtësi në luftime. Në betejë e fundit mars 1945, duke sulmuar e treguar

si gjithnjë shembull të lartë heroizmi e guximi prej militanti komunist, fjalët e fundit ishin “Mos më qani. Vazhdoni luftën”! Është shpallur Dëshmor i Atdheut me vendim nr. 104, datë 13.9.1969 të Komitetit Ekzekutiv të KP të rrethit Kukës.

Mos u shqetësoni, jam plagosur lehtë

Prek Mani lindi në fshatin Tetaj të Lekbibajt në vitin 1922. Familja e tij shquhej për ndjenja patriotike, ndaj regjimi zogist e persekutoi, ndaj familja u detyrua të largohej nga fshati dhe nisi jetën e kaçakëve, maleve e shpellave të Tropojës e të Kosovës. Preka jetoi për disa vjet në Romoc të Gjakovës. Aty vazhdoi klasën e katërt të fillores, ku u dallua për zgjuarsin e urtësi. Por atë e përjashtuan nga shkolla, mbasi xhaxhai i tij ishte i arratisur. Vuajtjet e burrëruan para kohe, e bënë më të fortë. Më 1937 u kthye në vendlindje së bashku me të afërmit e tij. Në tetor 1944 u bashkua me forcat e Br.XXVS. Ky ishte një gëzim për Prekën. Në luftimet në Qafë të Kolpit ashtu dhe në luftimet e tjera për çlirimin e asaj zone u tregua i zgjuar e trim. Në nëntor 1944, mbas çlirimit të Tropojës, Br.XXVS, vazhdoi luftën përtej kufirit për çlirimin e popujve të Jugosllavisë. Në luftimet që zhvilluan forcat partizane kundër gjermanëve dhe çetnikëve në territorin e Jugosllavisë Preka u shqua për guxim. Vdiq në duart e shokëve partizanë, në spitalin e Ivanës, nga plagët e rënda që mori në luftimet e zhvilluara në malin Judovnik, në janar 1945.

Është shpallur Dëshmor i Atdheut me vendim nr. 52, datë 04.11.1969 të Komitetit Ekzekutiv të KP të rrethit Tropojë.

Jam mirë, vazhdoni rrugën...

Oso Cakraj ishte 17 vjeç, kur në mëngjesin e 28 gushtit 1943, shkonte drejt Valbonës për të marrë pjesë në kuvendin historik të Malësisë. Ai ishte lindur në vitin 1926 në një familje të varfër, por Oso i kuptonte problemet e mëdha të popullit dhe kishte pjekurinë e një burri të rrahur në jetë. Mori pjesë në mbledhjet e formimit të batalionit territorial “Rinia”, më 27 nëntor 1943, në fshatin T’plan. Ndërsa, më 6 nëntor 1944, me krijimin e Br.XXVS u radhit në batalionin e dytë të brigadës. Luftëtarët kishin parë tek Oso tipare të karakterit të tij, humor të këndshëm, besim në fitoren dhe të ardhme të lumtur.

Në dimrin e ashpër Oso me luftëtarë po i ngjiteshin malit të ashpër për të ndjekur nazizmin dhe përtej kufijve të atdheut. Oso kishte zënë një pozicion luftimi, kur një predhë mortaje gjermane qëllloi pranë tij. Luftëtarin e ri e mbuloi dhe u bora. Oso u ngrit dhe duke shkundur dheun e borën, pa shokë të shqetësuar që e shikonin dhe u tha: “Nuk kam gjë, jam mirë”. Pastaj u përkul, zuri vend në pozicion dhe filloi të shtjerë pa pushim mbi fashistët. Kështu, me vetëmohim luftoi Oso në të gjitha betejat ku mori pjesë. Por në rrugën dimërore plot ngrica e të ftohtë jashtë atdheut përveç gjermanëve e reaksionarëve vendas, u shfaq dhe një armik i ri, sëmundja e tifos. Pikërisht në një “spital” me të sëmurë të tillë, u nda nga shokët dhe djaloshi 19-vjeçar nga fshati Lugaj, Oso Daut Cakraj, në fillimin e muajit prill 1945. Ai është shpallur “Dëshmor i Atdheut”, me vendim nr. 52, datë 04.11.1969 të Komitetit Ekzekutiv të KP të rrethit Tropojë.

Fëmijët e Luftës: Nga Ndhimës në Heroj, nga Viktima në Simbole

Përdorimi i fëmijëve gjatë Luftës së Parë dhe të Dytë Botërore është një kapitull i dhimbshëm dhe kompleks i historisë, dhe ka ndodhur për një sërë arsyesh strategjike, politike, shoqërore dhe psikologjike. Gjatë luftërave, shumë burra të rritur u mobilizuan në front, duke krijuar mungesë në fuqinë punëtore.

Për të mbushur këtë boshllëk, shumë fëmijë u detyruan të punonin në industri (sidomos në prodhimin e armëve, municioneve, dhe pajisjeve ushtarake), ose u rekrutuan në ushtri, sidomos në role ndihmëse si lajmëtarë, mbartës të municionit, ndihmësmjekë etj.

Indoktrinimi dhe propaganda

Regjimet totalitare, si ai nazist në Gjermani apo ai fashist në Itali, përdorën sistematikisht propagandën për të indoktrinuar fëmijët me ideologjinë e regjimit.

Organizata si Hitlerjugend (Rinia e Hitlerit) i përgatitën fëmijët për luftë që në moshë të vogël, duke i bërë të gatshëm për të sakrifikuar jetën për atdheun.

Spiunazh dhe role të fshehta

Fëmijët, për shkak të pamjes së tyre “të pafajshme”, shpesh përdoreshin për të transportuar mesazhe ose për të përgjuar armiqët.

Në disa raste, ata ndihmonin rezistencën lokale ose grupet partizane, duke mbledhur informacione ose ndihmuar me furnizime.

Në shumë vende, fëmijët shprehën vullnetin për të ndihmuar vendin e tyre. Disa shkuan në luftë nga dëshira për të qenë heronj, të frymëzuar nga prindërit, propaganda, apo mjedisi shoqëror.

Shfrytëzimi dhe mungesa e mbrojtjes ligjore.

Në atë kohë nuk ekzistonin ligje të qarta ndërkombëtare që ndalonin përdorimin e fëmijëve në konflikt. Në mungesë të mbrojtjes ligjore dhe morale, shumë ushtri dhe qeveri nuk ngurronin t’i përdornin ata për qëllime lufte.

Përfshirja e fëmijëve në luftë ishte një pasojë tragjike e nevojës, ideologjisë dhe mungesës së mbrojtjes. Pas përfundimit të Luftës së Dytë Botërore, ky fenomen u dënua gjerësisht dhe shumë konventa ndërkombëtare, si Konventa për të Drejtat e Fëmijës e OKB-së, u krijuan për të parandaluar që fëmijët të përfshihen në konflikte të armatosura.

Roli i fëmijëve shqiptarë gjatë Luftës së Dytë Botërore

Fëmijët shqiptarë gjatë Luftës së Dytë Botërore luajtën një rol shumë të veçantë dhe shpeshherë heroik, edhe pse në mënyrë tragjike, sepse u përfshinë në një konflikt shumë të ashpër për moshën e tyre. Shqipëria ishte e pushtuar dhe e përfshirë në një luftë të madhe çlirimtare kundër pushtuesve italianë e më pas gjermanë, dhe fëmijët shpesh nuk kishin zgjedhje tjetër përveçse të përfshiheshin.

Lidhja e fëmijëve me rezistencën partizane

Shumë fëmijë, veçanërisht adoleshentë, u bashkuan me forcat partizane shqiptare, duke marrë pjesë në aksione ushtarake, bartje armësh, informacione, apo duke vepruar si ndërlidhës mes çetave.

Ata nuk ishin formalë si ushtarë, por luanin role shumë të rëndësishme në komunikim, furnizim dhe informim.

Disa fëmijë ndihmonin në shpërndarjen e trakteve ilegale, gazetave antifashiste, apo mbledhjen e informacionit për lëvizjet e forcave pushtuese.

Disa prej tyre ishin pjesë e rinisë komuniste, organizatë që i përgatiste që në moshë të re për të qenë “ushtarë të popullit”.

Viktima të masakrave dhe dhunës

Një nga anët më të errëta është se shumë fëmijë u vranë në masakra të organizuara nga pushtuesit si ndëshkim ndaj popullsisë që strehohej apo ndihmonte partizanët.

Një shembull i tmerrshëm është Masakra e Borovës (6 korrik 1943), ku forcat gjermane dogjën fshatin dhe vranë 67 fëmijë bashkë me gratë dhe pleqtë.

Jeta në ilegalitet

Shumë fëmijë jetonin në kushte shumë të vështira, në male apo në qytete të pushtuara. Ata shpesh ndihmonin familjet me punë të rënda ose edhe ndihmonin të mbijetonin anëtarët e plagosur të familjes që ishin pjesë e luftës.

Fëmijët shqiptarë nuk kishin fëmijëri të zakonshme gjatë



luftës — ata u rritën përpara kohe, mes dhunës, vuajtjeve dhe sakrificës. Kontributi i tyre, edhe pse shpesh i harruar, është një dëshmi e qëndresës dhe guximit të popullit shqiptar.

Roli dhe kontributi i pionierëve në luftën për çlirimin e vendit, ka qenë i rëndësishëm. Të grupuar në organizatën e tyre DEBATIK, ata kryen jo vetëm shërbime të ndryshme në ndihmë të luftës në front e prapavijë, në të gjithë vendin, por ndonëse në moshë të re, shumë prej tyre u rreshtuan në repartet e njësive partizane e luftuan me heroizëm krahas të rriturve...

Në shkurtin e vitit 1942, në kodrat e Saukut në Tiranë, atje ku sot ngrihet një lapidar i thjeshtë, por me një histori të lavdishme, u krijua Organizata e Fëmijëve të LANÇ, (Djemtë e bashkuar, anëtarë të idealeve komuniste). Kjo nuk ishte një iniciativë e rastit, por e frymëzuar nga idealet e mëdha të çlirimit të vendit, kundër pushtuesve nazifashistë e bashkëpunëtorëve të tyre, ideale këto të cilat erdhën në botën dhe ndjenjat e këtyre fëmijëve 12,13 e 14 vjeçar, nëpërmjet më të rriturve, prindërve të tyre, të rinjve dhe anëtarëve të Qarkorit të Partisë Komuniste të Tiranës, nëpërmjet bisedave me ta, si dhe përmes shembullit të tyre gjatë betejave kundër pushtuesve. Nga 7 prilli 1939, kur u pushtua vendi ynë nga Italia fashiste e gjer, më 10 shkurt 1942, ishin zhvilluar shumë ngjarje, shumë beteja, të cilat, si tek i gjithë populli shqiptar, te rinia shqiptare, ashtu edhe te këta fëmijë, krijuan mbresa, dhimbje, por edhe krenari e angazhim. Rrjedhimisht, ata, me logjikën e tyre fëmijërore, por të mençur e të pjekur, bënë një betim solemn: “Edhe ne do të luftojmë pushtuesit e huaj dhe tradhtarët e vendit”. Pas kësaj, Debatikasit, nëpërmjet një organizimi të përsosur, me drejtues trima e më të përgatitur, gjithmonë nën drejtimin e anëtarëve të celulave të Partisë, me guxim e trimëri dhe me atë ndjenjë e përgjegjësi si prej të rrituri, me atë konspiracion e ruajtje, si gjë të shenjtë të sekreteve, morën përsipër dhe kryen detyra,

sa delikate aq dhe të rëndësishme, duke vepruar në radhët e në prapavijat e armikut, në afërsi të reparteve ushtarake, në vende me rrezikshmëri të lartë, ku mund të ikte koka, etj. Sa e sa prej tyre, shpërndanin nën hundë të armiqve, komunikata, kalonin nga një zonë e lagje në tjetrën, me materiale propagandistike e letra sekrete, por edhe me armë nga qyteti i Tiranës, në Pezë.

Mblidhnin ndihma, veshmbathje, monedha, grumbullonin informacione mbi lëvizjen e armikut, merrnin pjesë në aksionet për grisjen e flamurëve të fashizmit e qarkore të afishuara prej tyre, por jo rrallë edhe si pjesëmarrës në aksionet luftarake që kryenin njësitet guerile. Por e gjithë kjo veprimtari e debatikasve, nuk mund të kalonte lehtë. Spiunët e shumtë në shërbim të nazifashistëve, binin në gjurmë të tyre. Kjo bëhej shkak që ata, të largoheshin në terren e në mjaft raste të rroknin armët e të rreshtoheshin në formacionet partizane, pati edhe nga ata debatikas, që nuk e gëzuan dot ditën e lirisë, sepse ranë në betejat për të mos vdekur kurrë. Të tillë kanë qenë: trimi Met Hasa, i cili, për të shpëtuar shokët, mbuloi me gjoksin e tij të njomë mitralozin nazist, apo Ylbere Bylylbashi, e cila ra duke luftuar tej kufijve shtetërore, ndërsa më i vogli debatikas, Fiqiri Begeja, priti në gjoksin e tij të vogël në Prishtinë, plumbat naziste. Heroizmi i paparë i Antoneta Vretos, përballë xhelatëve nazistë edhe pse e torturuar mizorisht, nuk tregoi asgjë para tyre, akte këto që historia i ka shkruar me germa të arta. Por duhet theksuar se shembulli dhe përvoja e ngritjes së Organizatës së DEBATIK-ut në Tiranë, u përhap me shpejtësi në tërë Shqipërinë. Edhe pse fëmijët në të gjithë vendin, ndihmonin LANÇ, pas kësaj ngjarje, ata u përfshinë në një organizim të tillë, diku me emrin DEBATIK e diku organizatë pionieri.

Anëtarët e organizatës DEBATIK, apo siç u quajt e Pionierit, dhanë një kontribut të rëndësishëm gjatë Luftës Antifashiste Nacionalçlirimtare, ata u rritën e u burrëruan gjatë kësaj epopeje të lavdishme.



REPUBLICA E SHQIPËRIE
MINISTRIA E MBROJTJES



ATDHEU NDERI DETYRA

Bëhupjesë
Forcat E Armatosura
Karrierë Ushtarake
FA Shqiptare